NË KËTË NUMËR LEXONI


3 Pyetësor për pavarësinë e Kosovës


14 Integrimi evropian kalon nga bashkimi shqiptar


20 Bujqit fajësojnë Qeverinë


26 Agjërimi Ligj i Zotit


36 Mjalti ilaç i ëmbël

Lajme 2

Milazim Krasniqi: Pyetësor për pavarësinë e Kosovës 3

Intervistë me Mazllum Baraliun 4-6

Gëzim Qerimi: 1440 studentë për 100 mijë banorë 7-8

Burim Xhemajli: Pak investime për fillim të vitit shkollor 9

Avni Avdiu: Postmodernja te shqiptarët 10-11

Mergim Lushtaku: Filloi........ 12

Sead Ujkani: Shtohet numri i të papunëve me fakultet 13

Koço Danaj: Integrimi evropian kalon nga bashkimi shqiptar 14-15

Arber Zeka: Pavarësia e adoleshentit, sfidë e madhe 16-17

Demir Reshiti: Edhe "treshja", në prag të dështimit 18-19

Osman D. Gashi: Bujqit fajësojnë Qeverinë 20-21

Mehmet Shkëmbi: A po rrënohet qemalizmi në Turqi .. 22-23

Shkelzen Rrecaj: Politizimi i institucioneve të dijes 24

Muhamed Jusufi – Kajolli: Betejat e myslimanëve në gadishullin arabik 25

Muhamed Jusufi – Kajolli: Agjërimi Ligj i Zotit 26-27

Agron Islami: Shqiptari që shkroi himnin e Turqisë 28-29

Flamur Maloku: Përshëndetja e gjakosur personale 30-31

Rrahman Ferizi: Koha e çmon fjalën (poezi) 32

Zahrije Kapllanaj: Prej jetës në letërsi 33

Mirsad Kuteli: Ruajtja e strukturës familjare 34

Kuriozitete 35

Iliriana Alloqi & Artan Bejta: Mjalti- ilaç i ëmbël 36-37

Bujar Sejdiu: Fobitë 38

Shkelzen Nuza: Strategjia se si ta fitosh një punë 39

Fjalëkryqi 40

REDAKSIA E REVISTËS "PAQJA", TË GJITHË BESIMTARËVE TË FESË ISLAME UA URON MUAJIN E BEKUAR TË RAMAZANIT



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti I / Nr. 10
19 Shtator 2007

Botues



O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor gjuhësor
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redakisisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Prishtinë

31 Gusht

Ruecker shpall zgjedhjet për në nëntor



Zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale në Kosovë do të mbahen më 17 nëntor paralelisht me procesin e zgjidhjes së statusit. Kështu ka vendosur shefi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Joachim Ruecker, pas takimit me Ekipin Negociator të Kosovës.
Zgjedhjet do të mbahen sipas sistemit me lista të hapura dhe partitë politike duhet të marrin së paku 5% të votave për të siguruar përfaqësimin e tyre në parlament.
Kjo kuotë nuk vlen për subjektet politike të pakicave, të cilat kanë vende të rezervuara ne Kuvendin e Kosovës.

Ankara

28 Gusht



Abdullah Gyl, president i ri i Turqisë

Abdullah Gyl, me 339 vota pro është zgjedhur president i ri i Turqisë. Gyl do të pasojë presidentin Ahmet Nexhdet Sezer.
Në raundin e tretë të zgjedhjeve presidenciale, Abdullah Gyl fitoi para Sabahattin Cakmakoglu (70 vota) nga Partia e ekstremit të djathtë MHP dhe Tayfun Icli 13 vota.
Ne votim kanë marrë pjesë gjithsej 448 deputetë nga gjithsej 550 sa numëron parlamenti turk.
Votimin e ka bojkotuar partia e majtë CHP me liderin e saj Denis Baykal.

Shuhen dy yje të skenës

23 Gusht

Faruk Begolli

PRISHTINË

Aktori i njohur dhe profesori Faruk Begolli ka vdekur dhe është varrosur në Prishtinë në moshën 63 vjeçare nga një sëmundje e gjatë dhe e rëndë. Begolli ka lindur në Pejë, ndërkaq akademinë e teatrit e ka kryer në vitin 1966 në Beograd. Vitet e fundit ka punuar si profesor në fakultetin e arteve në Prishtinë.
Faruk Begolli ka luajtur në mëse 70 filma dhe seriale televizive dhe konsiderohet si njëri ndër artistët më të njohur në Kosovë dhe më gjërë.



6 Shtator

Luciano Pavarotti

MODENË, ITALI

Një prej këngëtarëve më të mëdhenj e më të njohur të operës, Luciano Pavarotti, ka ndërruar jetë.
Tenori italian, i cili u diagnozua me kancer në pankreas vitin e kaluar, vdes në shtëpinë e tij në Modenë, në moshën 71 vjeçare.
Luciano Pavarotti pati një karrierë dyzetvjeçare në skenën botërore dhe brenda kësaj kohe u bë një prej artistëve më të shitur, krah për krah me artistë si Madonna dhe Elton John.



Ana tjetër e medaljes

PYETËSOR PËR PAVARËSINË E KOSOVËS

1. A keni marrë pasaportë të Serbisë brenda këtyre tetë vjetëve? 2. A keni futur mallra kontrabandë në Kosovë? 3. A keni dhënë para për të marrë një dokument në komunë? 4. A keni uzurpuar ndonjë shtëpi ose ndonjë dyqan të qytetarëve që janë zhvendosur nga Kosova?
Përgjigjet në këto pyetje dhe në disa të tjera që janë në këtë tekst, na bëjnë bashkëpërgjegjës për vonesën e pavarësisë së Kosovës



Milazim KRASNIQI

Statusi i Kosovës po rri pezull, për shkak të shtyrjeve të afateve, të tejzgjatjes së negociatave dhe të konfuzionit që mbretëron në komunitetin ndërkombëtar për të ardhmen e këtij vendi. Kjo është linja e shpjegimeve standarde që bëjnë të gjithë politikanët, diplomatët dhe analistët. Në këtë konstatim ka një të vërtetë. Por, nëse gërmohet më thellë në shkaqet që e kanë inkurajuar komunitetin ndërkombëtar që të shtyjë afate, që të devijojë procesin e të prodhojë konfuzion, atëherë mund të dilet edhe në terrenin ku do të shihen edhe dobësitë e shoqërisë së re të Kosovës, të cilat janë bërë pengesa e pavarësimit të vendit. Edhe pse duket sheshit se nuk na pëlqen të shihemi në pasqyrën e realitetit, këtu më poshtë po bëjmë një pyetësor me anën e të cilit mund të zbulojmë edhe fytyrën tonë të vërtetë në raport me pavarësimin e Kosovës. (Pyetjet që parashtrohen këtu, mund të vlejnë për të gjithë qytetarët e Kosovës, por më së shumti për ne shqiptarët.)

1. A keni marrë pasaportë të Serbisë brenda këtyre tetë vjetëve?
2. A keni futur mallra kontrabandë në Kosovë?
3. A keni dhënë para për të marrë një dokument në komunë?
4. A keni uzurpuar ndonjë shtëpi ose ndonjë dyqan të qytetarëve që janë zhvendosur nga Kosova?
5. A e keni paguar tatimin në pronë gjatë këtyre tetë viteve?
6. A e keni paguar energjinë elektrike gjatë këtyre viteve?
7. A e keni lidhur shtëpinë tuaj ilegalisht në ujësjellës?
8. A e keni kërcënuar ose sulmuar policinë e Kosovës, kur ju ka ndalur në komunikacion?

Përgjigjet, nëse do të jenë të sinqerta, do të zbulojnë defektin e rëndë që ka mbretëruar gjatë këtyre tetë vjetëve në organizimin e shoqërisë sonë. Sidoqoftë, këtu më poshtë po sjellim disa të dhëna që e ndihmojnë përgjigjen e secilit prej nesh.

1. Vetëm në qarkun e Nishit janë marrë 170.000 pasaporta deri sot nga shqiptarët e Kosovës, gjatë këtyre tetë vjetëve të administrimit ndërkombëtar mbi Kosovën. Kur t'i shtohet kësaj shifre numri i pasaportave të marra në qarqet e tjera, si dhe pasaportat e marra prej bashkatdhetarëve tanë në diasporë, rezulton se ka vazhduar "bashkëjetesa administrative" me Serbinë, në dëm të krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës.

2. Futja e mallrave kontrabandë në Kosovë, veçmas të mallrave nga Serbia, në bashkëpunim me serbët, ka qenë "veprim patriotik" gjatë këtyre tetë vjetëve, i cili ka varfëruar buxhetin e Kosovës, e varfëruar ekonominë e vendit dhe ka dhënë provë se Kosova nuk mund të mbijetojë ekonomikisht pa Serbinë.



3. Korrupsioni është bërë mënyrë sjelljeje e qytetarëve, gjë që e ka paraqitur Kosovën si një vend të infektuar kolektivisht nga virusi i korrupsionit.

4. Uzurpimi i pronave të huaja, të cilat nuk janë liruar as pas tetë vjetëve, është bërë një njollë turpi për Kosovën dhe i ka inkurajuar ata që mendojnë se Kosova duhet të ndahet, sepse serbët janë viktima të abuzimit.

5. Mospagesa e tatimeve i ka bërë komunat të jenë të varfra e pa mundësi që të bëjnë shërbime të duhura për qytetarët. Prandaj, shumë njerëz sot e kujtojmë me nostalgji kohën e socializmit, kur komuna bënte më shumë për ta.

6. Vjedhja e energjisë elektrike është një dukuri shumë e përhapur. Edhe mospagesa e energjisë elektrike është poashtu një "dukuri nacionale". Por, kjo e ka penguar zhvillimin e vendit, i ka penguar investimet dhe e ka stimuluar ekonominë informale. Kolapsi energjetik i tejzgjatur e ka paraqitur Kosovën në sytë e kundërshtarëve te pavarësisë si një vend të paaftë për t'u vetëqeverisur.

7. Lidhjet ilegale në ujësjellës janë një dukuri poashtu e shëmtuar dhe e cila e çrregullon furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm e prej këndej edhe e ulë kualitetin e jetës së tyre. Ndërsa, në kontekstin e statusit, edhe kjo inkuadrohet si minus për pavarësinë e vendit.

8. Sulmet ndaj policëve të Kosovës gjatë kësaj periudhe kanë qenë të shpeshta, dhe e kanë kompromentuar idenë se SHPK mund të jetë garant i sigurisë në Kosovë. Prandaj, edhe janë bërë më të zëshëm, ata që kërkojnë që të kthehet ajo policia e vjetër serbe, e cila di si ta vendos rendin në këtë vend.

Mund të bëhen edhe shumë pyetje të tjera, por jemi kufizuar vetëm në këto, për mungesë hapësire. Por, nëse të gjithë ne japim përgjigje të sinqerta në pyetjet e mësipërme, do ta kuptojmë më lehtë pse po ndodhin gjithë këto zhegitje dhe komplikime me fatin e vendit tonë. Do të mund të kuptojmë një gjë themelore: ne nuk e kemi krijuar shtetin, i cili mund të funksionojë dhe të jetë i aftë ta mbajë veten me punën e shtetasve të vet. Ne më shumë për këto tetë vjet kemi zhvatur nga buxheti i Kosovës dhe nga ndërmarrjet publike, se sa që kemi kontribuuar për forcimin e tyre. Ne ende sillemi sikur nuk e dimë se shteti bëhet e pastaj kërkohet njohja e tij (ne po e kërkojmë njohje për shtetin që nuk e kemi bërë të aftë të funksionojë vetë). Ne ende nuk e kemi nda mendjen a e duam përnjëmend këtë vend si atdhe, që duhet ta bëjmë të përparuar e të zhvilluar apo vetëm si një hapësirë ku duam të "bëhemi idare" si të mundemi. Prandaj, kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës edhe janë trimëruar nga mungesa e përgjegjësisë sonë qytetare dhe nga mungesa e dashurisë vepruese për ta bërë Kosovën një shtet vërtet të pavarur.

Intervistë me Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), Mazllum Baraliu

Edhe këto zgjedhje me rregullore të UNMIK-ut

- Proces zgjedhor me shumë risi;
- Pragu zgjedhor i diskriminon partitë e vogla shqiptare;
- Edhe këtë radhë pa ligje vendore;
- 180 mijë votues të rinj...;

Intervistoi: Demir Reshiti

Zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale në Kosovë do të mbahen më 17 nëntor. Kështu ka vendosur shefi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker, pas takimit me Ekipin Negociator të Kosovës.

Organ vendor menaxhues i zgjedhjeve, për zbatim të operacioneve zgjedhore është Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ).

Për t'u njohur më për së afërmi me punën që po bën ky sekretariat në përgatitjen e procesit zgjedhor, biseduam me kryeshefin ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), mr. Mazllum Baraliun.

PAQJA: A është SKQZ-ja e përgatitur profesionalisht dhe a ka resurse të mjaftueshme humane për ta përballuar ketë proces ?

BARALIU: Jemi të përgatitur profesionalisht dhe konsideroj se jemi në gjendje ta përballojmë procesin zgjedhor, i cili kësaj radhe do të ketë më tepër punë sepse po organizohen tri, gjegjësisht katër palë zgjedhje njëkohësisht. SKQZ-ja ka një përvojë të mirë që nga viti 2000 dhe me sukses i ka realizuar deri më tani katër palë zgjedhje.

PAQJA: A mendoni se ka kohë të mjaftueshme për të përgatitur organizimin e zgjedhjeve?

BARALIU: Kohë të mjaftueshme nuk ka. E thash edhe më herët që një kohë optimale e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve në kushte normale, do të ishte 6 muaj, mirëpo kohën që e kemi nuk është produkt i dëshirës sonë, por obligim i yni që të respektojmë këtë afat, që e ofron kjo kornizë kohore prej dy muaj e gjysmë në bazë të vendimit të PSSP-së, dhe ne do të bëjmë maksimumin që ta kryejmë detyrën tonë brenda kësaj kornize kohore.



PAQJA: OSBE-ja ka pasur rol kyç në organizimin e zgjedhjeve të mëparshme. Sa po iu ndihmon kjo organizatë, duke marrë parasysh kohën e shkurtër për përgatitje të zgjedhjeve?

BARALIU: Sa i përket ndihmesës së OSBE-së, mund të them me përgjegjësi dhe sinqeritet se jemi duke bashkëpunuar në vazhdimësi. Kemi një bashkëpunim dhe koordinim të mirë. Në vazhdimësi kemi punuar me ta nëpërmjet grupeve punuese reciproke të ngritura më herët, dhe këtë vit e kemi shpallur vit aksionar, sepse e kemi ditur që do të ketë zgjedhje. Bashkëpunimi është në baza ditore, maksimal, gjithëpërfshirës dhe i plot, dhe ajo na ndihmon shumë me këshilla, me përkrahje, me komentet e tyre etj. Natyrisht ne kemi edhe qëndrimet tona të cilat i analizojmë bashkërisht, dhe më në fund në këshillat përkatëse të KQZ-së, merren vendime me konsensus.

Ky është një shembull i mirë i bashkëpunimit maksimal në mes të dy subjekteve, përkatësisht SKQZ-së dhe OSBE-së.

PAQJA: Cilat janë elementet reformuese që janë përgatitur për sistemin e ri zgjedhor?

BARALIU: Ka shumë, dhe ato janë produkt i disponimit të shoqërisë civile dhe subjekteve politike... Do të kemi një sistem me lista të hapura, futja e pragut zgjedhor, zgjedhja e drejtpërdrejt e kryetarëve të komunave, etj. Të gjitha këto risi dhe ndryshime janë përpunuar dhe analizuar përmes grupit tranzicional mbi zgjedhjet, i cili është mandatar nga Ekipi i Unitetit, dhe ka bërë një punë me vlerë për disa muaj me radhë gjatë vitit 2007.

PAQJA: Duke marrë parasysh se është një kohë e shkurtër dhe do të mbahen tri palë votime, sa do të ndikojë kjo në ndërlikimin e procesit të votimit?

BARALIU: Sigurisht se do të ndikoj shumë në ndërlikimin e procesit, sepse intervali kohor është shumë i shkurtër. Për të organizuar një palë zgjedhje në

kushte normale, nevojiten gjashtë muaj përgatitje paraprake, ndërkaq ne duhet të përgatisim tri palë, përkatësisht katër palë zgjedhje, meqë për kryetarë të komunave do të ketë edhe një raund të dytë, dhe kemi në dispozicion vetëm dy muaj e gjysmë.
Sigurisht që intervali kohor në dispozicion do të reflektohet dukshëm në cilësinë edhe të përgatitjeve edhe në efektet jo vetëm të KQZ-së, por edhe të subjekteve politike, e pse jo edhe të qytetarëve të cilëve ju duhet kohë që të orientohen dhe të përcaktohen për subjektin e caktuar politik.
Mirëpo, si organ ekzekutiv jemi të obliguar me ligj që t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë edhe vendimet dhe ligjet e organeve vendore dhe atyre ndërkombëtare të cilat janë në fuqi, dhe ne po bëjmë angazhim maksimal që t'ia dalim dhe të përgatisim zgjedhje edhe në këto kushte dhe korniza kohore, ashtu si duhet, në mënyrë që t'ia mundësojmë qytetarit tonë që të dal të votojë, pra ta motivojmë që të dal ta realizoj të drejtën e tij dhe të zgjedh përfaqësuesit e institucioneve qeverisëse që meriton t'i ketë Kosova.

Pragu zgjedhor i diskriminon partitë e vogla shqiptare

PAQJA: Çfarë efekti do të ketë vendosja e pragut zgjedhor prej 5 për qind?
BARALIU: Pragu zgjedhor është me pasoja negative ndaj subjekteve më të vogla politike shqiptare, sepse i godet ato në qoftë se nuk mund ta tejkalojnë pragun zgjedhor, dhe madje është diskriminues ndaj tyre, sepse në të njëjtën kohë nuk aplikohet për partitë e minoriteteve, të cilat janë të amnistuara nga ky kusht.
Mirëpo ka edhe efekte pozitive do të thosha, sepse ndikon në konsolidimin, në rirreshtimin, në profilizimin dhe pse jo edhe mobilizimin e subjekteve të caktuara politike të cilat për nga rezultati i votave të fituara më herët konsiderohen më të vogla, dhe do të ndikoj që ato të organizojnë koalicione parazgjedhore, dhe të shkojnë më të organizuar drejt zgjedhjeve, në mënyrë që ta tejkalojnë këtë prag dhe të jenë pjesë të institucioneve, dhe në një mënyrë ta japin kontributin e tyre në krijimin e një qeverisje të mirë që i nevojitet shumë popullit të Kosovës.
Pragu zgjedhor nga ana tjetër e konsolidon strukturën dhe mozaikun politik dhe i kondenson ato në më pak subjekte gjë që na e lehtëson punën ne si KQZ dhe në vend se të kemi punë gjatë certifikimit me 60 e sa parti, do të kemi me më pak subjekte. Kjo na e lehtëson edhe punën tonë gjatë procesit të certifikimit...

PAQJA: Si do të votojë diaspora? Zgjedhjet e kaluara qytetarët që jetojnë në botën e jashtme kanë pasur probleme në votim. Cila do të jetë forma e votimit për ta këtë herë?
BARALIU: Kemi ndërmarrë në vazhdimësi veprime për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve tona sa i përket diasporës... Në zgjedhjet e fundit ky lloj shërbimi nuk ka funksionuar më së miri. Ka qenë një numër fare i vogël i qytetarëve të diasporës që kanë shfrytëzuar të drejtën e votimit...Kemi vënë kontakte me klubet, asociacionet dhe shoqatat e ndryshme të qytetarëve të Kosovës që gjenden në diasporë.
Kemi vënë kontakte dhe kemi dërguar informacionet e nevojshme dhe materialet në tre mijë adresa, mirëpo për fat të keq përgjigje na kanë arritur nga një numër fare i vogël i qytetarëve tanë.
Kemi dërguar 1450 pliko me informacione përkatëse për tu treguar qytetarëve tanë për rëndësinë e zgjedhjeve dhe për të këmbyer me ta adresat në mënyrë që t'i furnizojmë ata me informacione përkatëse për zgjedhjet dhe t'i ndihmojmë ata që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për votim.
Kemi ndërmarrë edhe hapa tjerë konkret duke e intensifikuar bashkëpunimin me Ministrinë e Kulturës përkatësisht me departamentin e çështjeve jorezidente i cili tashmë ka kaluar (dhe është bërë mirë që ka kaluar) në Zyrën e kryeministrit, si një zyre e veçantë, gjë që unë e konsideroj si një avancim dhe si një dhënie e një vendi më të rëndësishëm mërgatës sonë, të cilës i kemi shumë borxh, sepse ka dhënë shumë për Kosovën...
Kemi bërë dhe po bëjmë përpjekje të vazhdueshme që ta inkorporojmë në këto zgjedhje edhe skemën e votimit elektronik, që do të ishte një lehtësi për ta edhe për ne.



Edhe këtë radhë pa ligje vendore

PAQJA: Zgjedhjet në Kosovë deri tani janë zhvilluar mbi bazën e rregullores së UNMIK-ut. A ka ndryshime për shkak të statusit të Kosovës dhe a keni bazë ligjore – rregulla zgjedhore për operacionet zgjedhore?
BARALIU: Nuk ka ndryshime. Është pritur që do të hartohen ligjet vendore në bazë të së cilave do të organizoheshin zgjedhjet, mirëpo kjo nuk ka ndodhur, për më tepër edhe plani i Ahtisaarit ka kërkuar që të ketë katër ligje për zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare, por kjo nuk ka ndodhur për shkak të shtyrjes së zgjidhjes së statusit...
Tani kemi një situatë kur është proklamuar data e mbajtjes së zgjedhjeve dhe me një shpejtësi të nevojshme është bërë ndryshimi dhe plotësimi i rregulloreve të mëparshme të UNMIK-ut, që kanë rregulluar çështje të ndryshme të zgjedhjeve në nivelet qendrore dhe lokale, dhe ato rregullore (3 sosh), janë nënshkruar këto ditë. Në bazë të këtyre rregulloreve, sipas të gjitha gjasave edhe do të mbahen zgjedhjet.
KQZ-ja në bazë të autorizimeve ligjore ka të drejtë që të nxjerr rregulla zgjedhore të këtij komisioni për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me strukturën e përgatitjes së zgjedhjeve. Për zgjedhjet që pritet të mbahen në nëntor të këtij viti i kemi miratuar disa rregulla, konkretisht rregullën 1, 2, 3 që kanë të bëjnë me certifikimin e subjekteve politike, lidhur me komisionet komunale zgjedhore, lidhur me vëzhguesit vendorë e ndërkombëtar, etj., dhe poashtu rregullën mbi kodin e mirësjelljes. Jemi në procesin e miratimit edhe të rregullave të tjera të cilat do të na ndihmojnë shumë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor...

180 mijë votues të rinj...

PAQJA: Sa persona me të drejte vote ka aktualisht në Kosovë? Sa prej tyre do të jenë votues të rinj?
BARALIU: Në bazë të të dhënave që kemi në dispozicion nga regjistri civil,

respektivisht ekstrakti i këtij regjistri i marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga ana e OSBE-së dhe pastaj i pasuar te ne, aktualisht ka dikund rreth një milion e pesëqind mijë votues.
Votues të rinj, nga viti 2004 kur janë mbajtur zgjedhje për herë të fundit e deri më tani janë 180 mijë, dhe ne jemi duke punuar intensivisht që këta të rinj t'i njoftojmë dhe t'i informojmë lidhur me rëndësinë e zgjedhjeve dhe të drejtën e tyre dhe t'i inkorporojmë ata në listën e re votuese të cilën jemi duke e plotësuar dhe azhuruar së bashku me UNMIK-un gjegjësisht OSBE-në dhe zyrtarët tanë ekzekutiv nëpër të gjitha komunat e Kosovës.

PAQJA: A ka të drejtë i njëjti kandidat të figurojë në të tri fletëvotimet?
BARALIU: Po, ka të drejtë të kandidohet, varësisht nga disponimi i subjektit përkatës, mirëpo, në qoftë se fiton në të trijat, atëherë duhet të heq dorë nga dy. Sidomos është me rëndësi në këtë rast të bëjmë një sqarim i cili nuk rezulton çdoherë si i saktë dhe i qartë.
Nga dispozita përkatëse e rregullës mbi certifikimin e subjekteve politike, në qoftë se konkurron kandidati i partisë përkatëse për të tri nivelet, dhe fiton bie fjala në të tri listat, nuk mund të heq dorë nga të qenit kryetar i komunës, sepse po hoqi dorë, atëherë zgjedhjet do të duhej të përsëritshin.
Zgjedhja e kryetarëve të komunave do të jetë dy raundshe. Në raundin e parë do të konkurrojnë kandidatë të caktuar dhe në raundin e dytë do të garojnë dy kandidatët që kanë arritur numrin më të madh të votave, me ç'rast do të zgjidhet ai që fiton më së shumti vota.

PAQJA: Votohet me lista te hapura. Sa është numri i kandidateve për të cilët mund të përcaktohet një votues?
BARALIU: Maksimumi është dhjetë. Votuesi ka të drejtë të përcaktohet prej një deri në dhjetë kandidatë në fletëvotim. Pra çdo qytetar i cili është i përcaktuar të votoj për një subjekt politik ka të drejtë që në këto zgjedhje të përcaktohet më së shumti për dhjetë kandidatë brenda listës së një partie, dhe jo më shumë. Nëse rastësisht i rrumbullakon më tepër se dhjetë, do të numërohen vetëm dhjetë të parët dhe fletëvotimi nuk do të konsiderohej si i pavlerë.

PAQJA: Si po kalon procesi i certifikimit të subjekteve politike, a keni hasur në ndonjë vështirësi?
BARALIU: Deri më tash nuk kemi asnjë problem serioz. Ne kemi bërë përgatitje paraprake disa muajsh. Kemi përgatitur në versionin elektronik (në CD) të gjitha materialet e nevojshme... Menjëherë mbas marrjes së vendimit për fillimin e certifikimit kemi marrë kontakt me të gjitha subjektet politike ku kemi



Pragu zgjedhor është me pasoja negative ndaj subjekteve më të vogla politike shqiptare, sepse i godet ato në qoftë se nuk mund ta tejkalojnë atë, madje është diskriminues ndaj tyre, sepse në të njëjtën kohë nuk aplikohet për partitë e minoriteteve, të cilat janë të amnistuara nga ky kusht

sqaruar të gjitha çështjet kontestuese ose të paqarta që i kanë paraqitur subjektet politike. Nuk kemi pasur deri më tani asnjë problem, gjë që dëshmon se përgatitjet kanë qenë në nivel nga ana e jonë, por edhe interesimi i partive politike ka qenë në nivel dhe mjaft aktiv. Subjektet politike i janë përmbajtur afatit të përcaktuar për paraqitjen e kërkesës për certifikim.

PAQJA: Sa ju mbështesin pushtetet lokale ne punën tuaj dhe a ka ndonjë politizim ne këtë drejtim?
BARALIU: Përkrahja e kuvendeve komunale është e plotë, bashkëpunimi është shumë i mirë dhe përkrahja e tyre ndaj komisioneve komunale zgjedhore është e plotë. Kemi pasur një koordinim të mirë të punës me kryeshefat ekzekutiv të komunave, dhe vazhdojmë të kemi bashkëpunim me të gjitha nivelet e institucioneve tona, sidomos me ministrinë e pushtetit lokal, me përkrahjen e së cilës kohë më parë kemi organizuar një takim me të gjithë kryeshefat e komunave ku në rend dite ka qenë çështja e njoftimit me procesin zgjedhor dhe njoftimi i tyre me një rregullore të UNMIK-ut e cila i obligon kuvendet komunale që domosdoshmërisht t'i përkrahin zyrtarët tanë ekzekutiv për çdo gjë që ata kanë nevojë në funksion të përgatitjeve sa më në nivel të zgjedhjeve. Pra bashkëpunimi është shumë i mirë edhe në funksion të sigurimit të zyrave, depove dhe kushteve tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

PAQJA: A keni mjete të mjaftueshme financiare për të bërë si duhet punët tuaja, dhe sa do të kushtojë në tërësi procesi i mbajtjes së zgjedhjeve?
BARALIU: Buxheti i ndarë është diku rreth shtatë milion, i paraparë që në vitin e kaluar, kur paramendoni, kanë qenë të parapara të mbahen vetëm një palë zgjedhje (ato lokale), ndërsa tani do të mbahen katër palë zgjedhje...
Sigurisht se këto mjete nuk janë të mjaftueshme, por ne shpresojmë dhe iu kemi bërë me dije edhe vitin e kaluar gjatë shqyrtimeve dhe rishqyrtimeve buxhetore, MEF-it, OSBE-së dhe Qeverisë që në rast nevoje të na dalin në ndihmë, në qoftë se dëshirojnë që të kemi zgjedhje të suksesshme, të drejta, demokratike e të paanshme...
Ne nuk kërkojmë më tepër se sa na nevojiten, nuk jemi shpenzues galoponte, jemi posaçërisht të kujdesshëm në shpenzimin e parasë publike dhe mjeteve buxhetore.
Por sidoqoftë ne jemi shumë të kujdesshëm dhe do të përpiqemi që ta kryejmë punën tonë, dhe obligimet tona edhe brenda mundësive të cilat i kemi.

PAQJA: Është caktuar se ku dhe nga kush do të bëhet shtypja e fletëvotimeve?
BARALIU: Jo. Kjo punë mbetet të bëhet. Kemi përgatitur specifikacionet. Jemi në përgatitje e sipër të materialit tenderues, dhe së shpejti pritet të shpallet tenderi, jo vetëm për këtë çështje por edhe për çështje të tjera, pra disa tenderë të cilët do të jenë të hapur edhe për ndërkombëtarë edhe për vendorë. Do të kihet kujdes në përzgjedhjen e kompanive më të mira në mënyrë që puna të bëhet e sigurt dhe ky operacion të përfundojë me sukses.

PAQJA: Ju faleminderit.
BARALIU: Ju falënderoj edhe juve për interesimin dhe shfrytëzoj rastin që t'i përshëndes lexuesit e respektuar të revistës PAQJA.

Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në Arsimin e Lartë në Kosovë

1440 studentë për 100 mijë banorë

Në vitin shkollor – akademik 2007/2008, numri i studentëve të regjistruar arrin rreth 39974 studentë, apo rreth 1440 studentë për 100 mijë banorë. Ky tregues është sa ¼ e Sllovenisë, më pak se ½ e Maqedonisë dhe sa 2/3 e Shqipërisë. Ky numër përfaqëson, gjithashtu, rreth 12% të popullsisë së grup moshës 18-25 vjeç në po këtë vit, duke qenë një normë përfshirjeje në arsimin e lartë rreth 4 herë më e ultë se ajo e vendeve të OECD-së.



Gëzim QERIMI

Universiteti i Prishtinës i themeluar në vitin 1970, është universiteti i vetëm publik në Kosovë. Aty zhvillohet mësimi në 17 fakultete, që përgatisin specialistë në 63 fusha. Studimet pasuniversitare ofrojnë 14 fakultete në rreth 30 fusha. Vitet e fundit është ngritur, gjithashtu, një universitet në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut dhe rreth 23 universitete private në Kosovë.

Numri i studentëve në arsimin e lartë ka ndryshuar mjaft sipas viteve. Ai ka pasur një zvogëlim të madh gjatë periudhës 1990-1999, që përkon me periudhën e funksionimit të sistemit paralel të arsimit. Më pas, numri i studentëve është rritur dukshëm në çdo vit.

Në vitin shkollor – akademik 2007/2008, numri i studentëve të regjistruar arrin shifrën rreth 39974 studentë, apo rreth 1440 studentë për 100 mijë banorë. Ky tregues është sa ¼ e Sllovenisë, më pak se ½ e Maqedonisë dhe sa 2/3 e Shqipërisë. Ky numër përfaqëson, gjithashtu, rreth 12% të popullsisë së grup moshës 18-25 vjeç në po këtë vit, duke qenë një normë përfshirjeje në arsimin e lartë rreth 4 herë më e ultë se ajo e vendeve të OECD-së.

Numri i aplikuesve për një vend të lirë në Universitetin e Prishtinës është mesatarisht katër herë me i madh se numri i të rinjve që dëshirojnë të vijojnë studimet në arsimin e lartë në Universitetin e Prishtinës por shumica prej tyre janë të privuar nga kjo mundësi.

Për një indeks konkurrojnë mesatarisht katër persona

Norma e ulët e përfshirjes në arsimin e lartë, në një kohë kur ka evidencë të qartë të rritjes së interesit të të rinjve për t'u regjistruar në universitet, lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin e kufizuar të institucioneve të arsimit të lartë. Numri i aplikuesve për një vend të lirë në Universitetin e Prishtinës është mesatarisht katër herë me i madh se numri i të rinjve që dëshirojnë të vijojnë studimet në



arsimin e lartë në Universitetin e Prishtinës por shumica prej tyre janë të privuar nga kjo mundësi. Ky kufizim kaq i madh ka krijuar kushtet të favorshme për subjektivizëm në pranimin e kandidatëve që regjistrohen në universitet. Të rinjtë mendojnë, se shpesh herë për t'u pranuar në universitet duhet të paguash ryshfet dhe këtë perceptim e kanë shumica e tyre. Të rinjtë shprehen se edhe pse vitet e fundit ka disa përmirësime në procesin e pranimeve në universitet, favoret vazhdojnë të jenë problem dhe se e keqja më e madhe është se studentët e pranuar me favore vazhdojnë t'i gëzojnë ato edhe gjatë viteve të studimit, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e studentëve të diplomuar. Gjithashtu mundësitë e pakta financiare janë një tjetër kufizim për të rinjtë me banim jashtë Prishtinës për të ndjekur mësimet në Universitetin e Prishtinës. Prindërit shprehen se mundën të përballojnë financiarisht shkollimin e fëmijëve deri në mbarim të shkollës së mesme. Më pas kjo bëhet shumë vështirë sepse të ardhurat e tyre nuk i kalojnë 150 Euro në muaj dhe nuk mund të përballojnë shpenzimet që i duhen një studenti në Prishtinë.

Numri i të diplomuarve çdo vit në arsimin e lartë ka pësuar gjithashtu luhatje të mëdha si rrjedhojë e vështirësive për të ndjekur arsimin e lartë gjatë sistemit paralel të arsimit të lartë. Numri i të diplomuarve është zvogëluar gjatë kësaj periudhe nga rreth 2200 të diplomuar në vit që ishte gjatë periudhës 1989-1999 në rreth 1000 të diplomuar në vit. Hyrja gjatë kësaj periudhe në tregun e punës e rreth 10 mijë të rinjve të diplomuar me pak dhe cilësia e ulët e arsimimit të atyre që u diplomuan në sistemin paralel kanë pasur ndikim të rëndësishëm në cilësinë e forcave të punës së Kosovës, prandaj kjo është cilësuar edhe si "periudha e gjeneratës së humbur". Aktualisht popullsia e moshës 25-64 vjeç në Kosovë është me nivel më të ulet arsimor krahasuar me të gjitha vendet e rajonit sepse vetëm rreth 13% e saj është me arsim të lartë, apo 18% e meshkujve dhe 8% e femrave.



Studimet jashtë Kosovës

Një numër i pa evidentuar saktë studentësh e ndjekin arsimin e lartë jashtë-Kosovës, shumica e të cilëve në universitetet e vendeve perëndimore. Perceptimi i të rinjve është se në përzgjedhjen e tyre bëhen favore dhe ka diskriminim. Këtë mendim e kam edhe unë personalisht pasi di raste konkrete rrethe këtij problemi. Gjithashtu është e kuptueshme se shumica e të rinjve mendojnë se studentët e diplomuar jashtë janë më të përgatitur se sa ata që diplomohen në Universitetin e Prishtinës dhe se kanë më shumë mundësi për t'u punësuar në Kosovë.

Sfidat e reformimit në arsimin e lartë në Kosovë

Procesi i Bolonjës

Procesi i Bolonjës për reformimin e arsimit mbështetet në këto parime kryesore:

• Përshtatja e sistemit krahasues të gradave shkencore, në mënyrë që ato të njihen lehtë kudo;

• Adaptimi i një sistemi të bazuar në dy cikle kryesore universitare (sistemi 3+2) që përfundon me diplomën Bachelor për ciklin e parë dhe me gradën Master për ciklin e dytë, dhe

• Vendosja e sistemit të krediteve në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve, si një instrument i përshtatshëm për lëvizjen e lirë të studentëve nga një universitet në tjetrin.

Vizioni i ri për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë është integrimi i tij në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik. Për përmbushjen e këtij misioni, arsimi i lartë përballet me dy sfida kryesore:

Rritja e kapacitetit, për t'i krijuar të rinjve mundësi më të mëdha për vazhdimin e studimeve universitare në kushtet të një infrastrukture të plotë e funksionale dhe për të kompensuar me shpejtësi numrin e pakët të diplomuarve gjatë më shumë se një dekadë;

Riaftësimi i thellë i përmbajtjes dhe përmirësimi rrënjësor i cilësisë, për t'i përshtatu ato me kërkesat e reja të tregut të punës dhe integruar në sistemin evropian të arsimit të lartë, në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës.

Domosdoshmëria e rritjes së cilësisë dhe e përshtatjes së shpejtë me kërkesat e tregut të punës lidhet drejtpërdrejt me mundësitë e studentëve të diplomuar për tu punësuar. Shpesh here kemi vejtur se përfaqësues të komunitetit të biznesit shprehen se në përgjithësi cilësia e studentëve të sotëm nuk i përgjigjet sa duhet kërkesave të biznesit. Kjo vjen edhe nga niveli i vetë pedagogëve i cili nivel nuk është i kënaqshëm. Ndërsa në universitetet private në Kosovë po vihet re tendenca e interesimit më shumë për numrin e studentëve dhe për përfitimet materiale se sa për cilësinë e tyre.

Suksesi i përmbushjes së këtij misioni kushtëzohet mjaft nga përmirësimi i menaxhimit të arsimit të lartë dhe sigurimi i burimeve financiare të nevojshme.

Viti i ri shkollor nis me probleme të vjetra

PAK INVESTIME PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR

Megjithëse Qeveria e ka përcaktuar si prioritet arsimin, pak risi ka sjellë në këtë fushë. Risia e vetme ka qenë reforma në klasë të pesta që pati shkaktuar debate… Zhvillimi i mësimit i klasave të pesta më vetëm një mësues ka lënë pa punë më shumë se 1200 mësimdhënës të klasave të pesta.

Burim XHEMAJLI

Përkundër kërcënimeve të sindikalistëve të arsimit nëpër media se do të ketë grevë në shtator, nxënësit dhe arsimtarët e shkollave fillore dhe të mesme e nisën vitin e ri shkollor.

E derisa kërcënimet e sindikalistëve u ndalën më nënshkrimin e marrëveshjes në mes të SBASHK-ut dhe Ministrisë së Arsimit për ngritjen 12 për qind të pagave, nxënësit edhe në këtë vit do të përballen me probleme të ndryshme.

Hapësira e vogël shkollore në krahasim me numrin e madh të nxënësve nëpër shkolla, do të bëj që edhe ketë vit mësimi të zhvillohet në dy e madje edhe në tri ndërrime.

Me gjithë premtimet e Qeverisë së arsimi do të jetë një nga prioritetet kryesore, mirëpo nuk është vetëm hapësira e vogël problem nëpër shkolla, por ka edhe shumë probleme të natyrës teknike.

Shkolla fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë është njëra nga shkollat që përballet me shumë probleme. Mbi 2000 nxënës të kësaj shkolle mësimin e bëjnë në tri ndërrime, nga ora 7 e mëngjesit e deri ne orën 7 të mbrëmjes.

> Fillimi i vitit të ri shkollor ka marrë edhe ngjyra politike. Caktimi i datës 17 nëntor për mbajtjen e zgjedhjeve ka bërë që krerët institucionalë të jenë prezentë si asnjëherë më parë në përurimin e atyre pak shkolla të reja që janë ndërtuar. Një gjë të tillë e ka bërë Presidenti Sejdiu, duke shfrytëzuar kështu javën e parë të vitit të ri shkollorë për përurime në disa komuna. Një gjë e tillë nga banoret e komunave si të Ferizajt dhe të Mitrovicës është cilësuar si kryekëput fushatë elektorale.

I gjithë ky numër i nxënëseve në këtë shkollë si dhe drejtuesit e kësaj shkolle kanë brengë dhe shumë probleme tjera. Inventari në këtë shkollë është i vjetruar. Një problem më të madh paraqet ndërrimi i mesditës, sepse gjatë kësaj kohe në shkollë mungon uji.

Drejtori i kësaj shkolle Shyqeri Obertinca zgjidhjen e problemit të ujit për orarin e mesditës e sheh në hapjen e disa puseve. Por ,sipas tij edhe kjo çështje ka mbetur të shqyrtohet në bashkëpunim me zyrtarët komunalë.

Me probleme të ngjashme ballafaqohen edhe shkolla të tjera fillore të kryeqytetit.

Në mungesë të hapësirës, kabinetet shndërrohen në klasa

Shkolla fillore "Elena Gjika" në Prishtinë përballët gjithashtu me shumë probleme, si: hapësira e vogël në krahasim më numrin e madh te nxënëseve, inventari i vjetër, etj.

Mungesa e hapësirës shkollore nëpër shumë shkolla ka shtyrë drejtuesit e tyre që disa kabinete të Biologjisë dhe Kimisë që i kanë pasur me sadopak pajisje, t'i shndërrojnë në klasa.

Të vetmet kabinete që kanë mbetur janë ato të informatikës, madje edhe këto kabinete më përafërsisht 20 kompjuterë në shumë shkolla kanë ardhur si donacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Duke u arsyetuar se mungesa e mjeteve financiare për pajisjen e shkollave me kabinete, institucionet qendrore dhe lokale, pothuajse investimin e vetëm e kanë bërë në gëlqerosjen e disa shkollave, madje në disa raste vetëm muret e brendshme të shkollave.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, muajt e verës janë shfrytëzuar për ndërtimin e rreth 16 mijë metra katror hapësirë të re shkollore, prej të cilave, 1000 metra katrorë llogariten të jenë shtuar si anekse të shkollave.

Reformat ne klasë te pesta vlerësohen jofunksionale

Lëshimi i një udhëzimi administrativ nga Ministria e Arsimit në qershor për fillimin e reformës në klasë të pesta, kishte shkaktuar atëherë shumë debate. Me këtë udhëzim administrativ me klasat e pesta do të punojnë nga një mësues eventualisht dy ose tre.

Ekspert te arsimit dhe prindërit kanë shprehur shqetësimin se nuk mund të jetë efikas një mësues në pothuajse të gjitha lendet.

"S'ma merr menja që mundet me i mesu tana lendet një mësues", është mendimi i Sami Imerit prind i një fëmije të klasës së pestë në Prishtinë. Kjo është edhe pika ku ekspert dhe prindër kanë pasur vërejtjet e tyre duke propozuar që kjo reformë të shtyhet për më vonë, derisa të jenë me të përgatitur mësuesit.

Por ministria nuk ka dëgjuar këta zëra dhe ka vendosur që të filloj më këtë reformë qysh tani më arsyetimin se mësuesit janë përgatitur.

Nga kjo reformë e Ministrisë së Arsimit kanë pësuar shumë arsimtarë..

Zhvillimi i mësimit i klasave të pesta më vetëm një mësues ka lënë pa punë më shumë se 1200 mësimdhënës të klasave të pesta. Kjo dhe ka qenë njëra nga pikat ku Ministria dhe SBASHK-u kanë nënshkruar marrëveshje për parandalimin e grevave.

Sindikalistët i kanë kërkuar Ministrisë që gjithë këtë numër te arsimtareve të kualifikuar të mos e lënë të papunë. Ndërkaq Ministria në anën tjetër ka premtuar së te gjithë mësimdhënësit e kualifikuar nuk do te mbesin papunë, duke premtuar sistemimin e tyre nëpër shkolla të fshatrave ku kuadri nuk është i kualifikuar, si dhe me sistemimin e tyre nëpër klasa më te larta. Këto dy të fundit vetëm sa kanë nisë te realizohen.

Postmodernja te shqiptarët

NJË BUZËQESHJE FILOZOFIKE NDAJ PËRPJEKJEVE PËR "EMANCIPIM"

Duke e parë qartë se çfarë nënkupton popullariteti, shumë femra kanë zgjedhur prerazi që të jenë sa më të zhveshura, që të përdridhen sa më shumë dhe që tregohen sa më 'cool'. Tërë këtë e bëjnë në emër të emancipimit... Mirëpo fare mirë është e qartë se të gjitha ekspozimet e kanë vetëm një emërues të përbashkët: përfitimin material.



Avni AVDIU

Në mënyrë eksplicite dhe implicite roli i femrës është degraduar tej mase. Ajo kudo dhe kahdo tani shikohet vetëm si objekt erotik ose seksual dhe asgjë më shumë. Tendenca dhe prirjet gjithnjë e më të mëdha për zhveshjen sa më shumë të saj në emër të emancipimit ia kanë humbur çdo vlerë që kishte dikur (nëse edhe e ka pasur).

Zbrazëtia postmoderniste konsiston në qëndrimin e përgjithshëm se synimi për liri që na premtuan sistemet e mëdha humaniste nuk mund të plotësohet.

Për rrjedhojë kjo është edhe arsyeja e vetme e përplasjes së postmodernizmit me feminizmin. Christine De Stefano postmodernizmin e konsideron si kohë e ardhur për meshkuj, por jo edhe për femra. "Forca gjithnjë ka qenë e ndërlidhur me meshkujt dhe mashkulloren, - shkruan Nancy Hartsock në analizën që i bën fuqisë dhe mendimit të Fukos për femrat.

Pothuajse të gjitha spotet televizive përmbajnë përplot imazhe të femrave të bukura, buzëqeshja, gjestikulacioni dhe lëvizjet e të cilave të magjepsin. Nuk ka asnjë projekt që ka dalur nga produksionet muzikore shqiptare që nuk pasqyron këtë 'logjikë'. Për të pasur spotet muzikore efektin maksimal ato bëhen në Maqedoni ose Serbi tek ekspertët maqedonas e serb (thuajse nuk paska të tillë shqiptarë!!!), të cilët i dinë fort mirë se cilat poza mund të jenë më tërheqëse. Prandaj pjesa dërrmuese e spoteve përfundon duke treguar se te kush është bërë: by Alexander ose by Dejan....etj...etj.



"Fiks Fare" - imitim nga televizionet italiane

Po ashtu nuk ka asnjë emision të karakterit argëtues në TV që nuk e ndjekë atë logjikë, p.sh: emisioni humoristik në TOP chanel "Fiks Fare" për t'i freskuar pauzat e humorit fton në studio dy valltare atraktive gjithashtu gjysmë të zhveshura për ta freskuar atmosferën. Emisioni është imitim nga televizionet italiane, ndërsa udhëheqësit e tij Saimiri dhe Doktori shpesh u gjuajnë fjalë provokative valltareve përmes të cilave fjalë shprehin 'kontributin' e tyre që po japin për ta bërë emisionin më të pasur. Në publicitet dhe gjatë emisionit vallëzimi erotik i tyre konsiderohet si pjesa më e ëmbël dhe më e nxehtë e emisionit.

Duke e parë qartë se çfarë nënkupton popullariteti, shumë femra kanë zgjedhur prerazi që të jenë sa më të zhveshura, që të përdridhen sa më shumë dhe që tregohen sa më 'cool'. Tërë këtë e bëjnë në emër të emancipimit, ndonëse feminizmi nuk e kupton këtë në mënyrë të tillë. Mirëpo fare mirë është e qartë se të gjitha ekspozimet e kanë vetëm një emërues të përbashkët: përfitimin material.

"Në këtë mënyrë aspektet e personalitetit shiten dhe blihen si çdo mall tjetër, theksonte me të drejtë", - Rajt Millsi. Femrat prostitutizojnë personalitetin e tyre që të krijojnë dobi personale.

Disa këngëtare për të arritur në majet e suksesit të karrieres së tyre, janë deklaruar hapur se pa kurrfarë komplekses do të xhironin edhe filma erotik. Zaten kjo edhe nuk është diçka aq skandaloze siç konsiderohej dikur. Një këngëtare për t'i arsyetuar skenat e saj pornografike të publikuara në internet, është shprehur prerazi se çdo çudi zgjat tri ditë. Ndoshta edhe më pak. E them këtë, sepse në kohën e bombardimit të pandërprerë medial ne presim granata edhe më të rënda, të cilat duke rënë vazhdimisht mbi kështjellat e moralit, do ta detyronin atë të ndihet i mposhtur.

Raportin e dijes dhe fuqisë Fuko e analizonte në shumë aspekte subjektive, duke përfshirë edhe sferën e seksualitetit. Duke a analizuar seksualitetin





nëpër histori prej antikës, pastaj mesjetës, renesancës e romantizmit deri te modernja, ai qartë tregon raportin e fuqisë dhe dijes dhe ndryshimin që ndodh në këtë vazhdë. Ai nxjerr përfundim se lidhja që është e pranishme mes tyre mund të karakterizohet me nocionet si represioni, ndalimi, kontrolli. Forca shfrytëzon institucionet siç janë sunduesi, shteti, kisha dhe institucionet tjera. Që të funksionojë forca, ajo duhet të posedojë dije. Kështu instalohen rregulla të ndryshme të sjelljes. Kështu që heqja dorë prej normave të tilla shpallet e gabuar, jonormale, sëmundje, rrezik dhe e dënueshme.

Është zhveshur iluzioni për shpirtëroren...

Dënimet në rrethana të ndryshme historike pësuan ndërrim të formës. Dija ka ushtruar ndikimin në qendrat e caktuara të forcës. Institucionet qeverisëse pastaj filluan t'ua përshtatin rrethanave të sapokrijuara, të vërtetave, dijeve... dhe në këtë mënyrë e përvetësuan lirinë dhe me këtë rast mbajtën edhe kontrollin. Ndalesat dhe kufizimet mbetën në fuqi. Kjo flet për atë se ekziston lidhja e dijes dhe forcës me represionin.
Historikisht është dëshmuar se të vërtetat e rëndësishme me kohë janë ndryshuar, sepse janë treguar të rreme dhe jo të sakta. Dëshira për të vërtetën është imanente te njeriu. Ndërkaq e vërteta është fuqi imanente.
Së këtejmi, zërat e çjerrur dhe të mekur kot ngriten si zhurmë kakofonike për të ftuar kah kthimi i asaj që konsiderohet si normalitet, sepse tani për tani mënyra më njerëzore e ekzistimit është 'çmendia', siç shprehet me të drejtë Dejvid Kuper në librin e tij "Gjuha e çmendisë".

Pra, është zhveshur iluzioni për shpirtëroren, ndërsa ndërgjegjiet dorëzohen edhe ashtu të molepsura. Ato janë të shokuara dhe në komë presin që vdekja klinike të shënojë edhe asfiksimin total. Turpi bëhet gjithnjë e më i durueshëm, më tolerant, më i lehtë, më indiferent dhe më i papeshë. Si ngushëllim për fund mund të jetë vetëm një buzëqeshje filozofike, e cila mund edhe të shkrehet në vaj, sepse del si refleksion i një situate që është edhe për t'u qarë edhe për t'u qeshur. E ne fatkeqësisht jemi mësuar të qeshim për ato gjëra që realisht duhet qarë për to.
Të gjithë atyre të cilët ende dëshirojnë të flasin për njeriun, për sundimin e tij ose për çlirimin e tij, të gjithë atyre që ende shtrojnë pyetjen për atë se çka është njeriu në esencën e tij, të gjithë atyre që dëshirojnë të nisen nga ai për të arritur deri tek e vërteta, të gjithë atyre të cilët, përkundrazi e reduktojnë çdo njohje në të vërteta njerëzore dhe atyre që nuk dëshirojnë formalizime pa antropologjisime, të cilët nuk dëshirojnë të mendojnë e që menjëherë të mos u shkojë mendja se këtë e mendon njeriu, të gjitha këtyre formave të të menduarit të shtrembër e të devijuar, mund t'ia kundërvëmë një buzëqeshje filozofike, e cila në të shumtën e rasteve është heshtje".

Pothuajse të gjitha spotet televizive përmbajnë përplot imazhe të femrave të bukura, buzëqeshja, gjestikulacioni dhe lëvizjet e të cilave të magjepsin. Nuk ka asnjë projekt që ka dalur nga produksionet muzikore shqiptare që nuk pasqyron këtë 'logjikë'. Për të pasur spotet muzikore efektin maksimal ato bëhen në Maqedoni ose Serbi tek ekspertët maqedonas e serb (thuajse nuk paska të tillë shqiptarë!!!), të cilët i dinë fort mirë se cilat poza mund të jenë më tërheqëse.

Fushata parazgjedhore

Filloi...

Po shihet se ka filluar fushata parazgjedhore, sepse, kanë filluar të rregullojnë rrugët e prishura, fakultetet, rinovimi i ndërtesave etj. Fatkeqësisht në kohën e fushatës parazgjedhore shpenzohen shuma të mëdha parash…



Mergim LUSHTAKU

Edhe në këto ditë të vështira në vend që t'u ndihmohet qytetarëve për t'u përballur me gjendjen reale në të cilën është Kosova, partitë politike jo që nuk e sqarojnë dhe nuk iu ndihmojnë qytetarëve të kuptojnë gjendjen e Kosovës por ata shkojnë me tutje, duke iu premtuar me gënjeshtra dhe me mashtrime se: ne do ta bëjmë ketë, e ketë, e ketë…

Përsëri qytetarët gjenden para një dileme të madhe dhe të turbulluar nga fushata parazgjedhore e partive, me koncerte, reklama të mëdha, marshim në këmbë etj.

Qytetarët në dilemë se a duhet të dilet në zgjedhje?

Shumë qytetarë e pyesin njeri-tjetrin përse ne duhet të dalim në zgjedhje, kur politikanët e zgjedhur përsëri nuk e realizojnë atë që e premtojnë, kur përsëri mendojnë të na mashtrojnë, kur përsëri nuk po na zgjidhin problemet por vetëm se po thellohen edhe me tepër në shantazhe, korrupsion, keq menaxhime, mashtrime…

Po shihet se ka filluar fushata parazgjedhore, sepse, kanë filluar të rregullojnë rrugët e prishura, fakultetet, rinovimi i ndërtesave etj. Fatkeqësisht në kohën e fushatës parazgjedhore shpenzohen shuma të mëdha parash, e kjo brenda një kohe shumë të shkurtër.

Rasti i fundit më eklatant është shtrimi me mermer i rrugës "Nëna Terezë" do nga ndërtesa e Qeverisë e deri të hoteli "Grand". Kësaj rruge edhe pse ishte në nivel të mirë, ia kanë futur eskavadorët dhe shuma e shpenzuar për "meremetimin" e saj, kap vlerën mbi një milion euro, dhe duket qartazi se një gjë e tillë lidhet me fushatën parazgjedhore. Mirëpo, kësaj here, duket se qytetarët e kanë kuptuar se ketë e bëjnë vetëm për të marrë një votë prej tyre.

Koncertet të organizuar nga partitë e mëdha të vendit për fushatën parazgjedhore jo vetëm me arsyen që të përfitojnë elektoratin, por për të pasuruar kulturën, shpenzojnë shuma marramendëse parash. Kjo bëhet në kohën kur qytetarët janë në një varfëri të skajshme. Këto parti në vend që paratë t'i shpenzojnë për zbutjen e kësaj varfërie, ata iu hedhin hi syve qytetareve që mos t'i ndjejnë dhimbjet e tyre dhe të koncentrohen në votime.



A thua edhe po të sigurojnë "Pavarësinë e Kosovës" këto parti, a do t'i rregullojnë çështjet e jetesës së qytetareve apo do veprojnë të njëjtën gjë siç kanë vepruar deri me tani. Duke mos i interesuar për zbutjen e varfërisë, të papunësisë, për shkollimin e fëmijëve tanë. Çka na nevojitet kaosi në Pavarësi, ku tani vetëm kemi një kaos të madh të problemeve.

Sikur të kishim zgjedhje çdo katër muaj?!...

Po të shohim anën tjetër, me mirë t'i kemi zgjedhjet çdo katër muaj apo çdo një vit, sepse para zgjedhjeve do të kemi iniciativa dhe ndërtime që do të bëheshin, pastaj qeveritaret do te ishin me të kujdesshëm për shkak se do të ishin zgjedhjet afër. Por fatkeqësisht kjo nuk është e mundur, pasi që kjo pastaj do të kishte hendek të madh legjitimiteti, atëherë qytetarët shin lodhur të kenë zgjedhje brenda një kohë shumë të shkurtër.

Mbetet vetëm që qytetaret të vetëdijesohen dhe të arsimohen, që të mos rrimë duarkryq ndaj asaj që është duke ndodhur.

Në ketë kohë duhet t'i themi vetës stop! Duhet të mendojmë për gjithë Kosovën, e jo vetëm për një rajon, në këto zgjedhje për dallim nga tjerat nuk duhet që të japim votën sipas rajonit, por sipas asaj se kush do të ishte më i ndërgjegjshëm që qytetarët të vetojnë më mirë.

Duhet që vetë qytetarët të kërkojnë të largohen apo të dënohen mafiozet, gjithashtu edhe të mos na përfaqësojnë në organet e shtetit. Nuk duhet të na ndodh që të vritet një polic vetëm për shkak se ai ka luftuar për rend dhe qetësi. Duhet vetë qytetarët të ndikojnë që zëri i tyre të dëgjohet, që Kosova të jetë një shtet me të drejtat themelore dhe që të mos shkelen ato.

Do të citoj Zhan Zhak Ruso-në, i cili thotë: Çdo ligj i paratifikuar nga populli, është zero, nuk është ligj. Populli anglez beson së është i lirë, e ka gabim: është i lirë vetëm gjatë zgjedhjeve parlamentare. Pas zgjedhjeve, është skllav, nuk është asgjë. Atë moment të shkurtër që populli është i lirë, e përdor lirinë e tij, për ta humbur përsëri. (Du contrat social, lib III, kap. XV). Ketë thënie e lidhi me fushatën parazgjedhore që është tani në Kosovë, në të cilën qytetarët tanë shpesh bien preh e tyre.

Qytetarët tanë duhet të jenë me largpamës dhe më të vetëdijshëm sa i përket votës. Shpesh mashtrohemi nga një veprim momental në fushatën parazgjedhore, pastaj sillen vërdallë dhe të penduar për votën e tyre, por atëherë bëhet vonë!

Studentët dhe tregu i punës në Kosovë

SHTOHET NUMRI I TË PAPUNËVE ME DIPLOMA FAKULTETI

Ekziston një pajtueshmëri e plotë si të niveli akademik arsimor, ashtu edhe tek komuniteti i biznesit se studentët e diplomuar nëpër institucionet tona arsimore hasin në vështirësi për t'u inkuadruar në tregun e punës, prandaj është e nevojshme që të kemi një koordinim në mes të tregut të punës në njërën anë si dhe sistemit arsimor në anë tjetër.



Sead UJKANI

Kanë kaluar tetë vite që nga përfundimi i luftës dhe në përgjithësi sikundër edhe në lëmit tjera, edhe sistemi arsimor në Kosovë ka shënuar ngritje, zhvillim dhe funksionalitet të dukshëm. Më gjithë ngecjet dhe gjurmët e thella që ka lënë periudha njëdekadëshe e izolimit të paraluftës si dhe trajtimi joadekuat dhe mungesa e fondeve publike edhe në periudhën e pas luftës.

Mirëpo, në përgjithësi në krahasim me gjendjen paraprake të paraluftës janë bërë hapa të mirë në drejtim të:

- Konstituimit dhe zhvillimit të strukturave organizative institucionale;
- Zhvillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës arsimore;
- Hartimit dhe përpilimit të plan-programeve mësimore konformë reformave të procesit të Bolonjës;
- Përpilimit të strategjisë së zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë për periudhën (2005-2015).

Reforma në sistemin arsimor në Kosovë është në proces e sipër, ndërsa fazën vijuese të implementimit të saj do ta karakterizoj evoluimi i punës së institucioneve përkatëse arsimore me theks të veçantë vlerësimi i performansave të nivelit akademik dhe të studentëve si pjesë përbërëse të procesit arsimor në mënyrë që të krijohen kushtet për një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Këto ditë ka filluar implementimi i projektit për përmirësimin e performancës të Universitetin e Prishtinës. Qëllimi i këtij projekti është që të ndihmohet UP-ja të dizajnoj organizatën, proceset e saj dhe funksionet në një mënyrë më efikase, në përpjekjet e që t'i arrij standardet ndërkombëtare. Partner të përbashkët implementues të këtij projekti janë: Universiteti i Prishtinës, World Learning- zyrës në Kosovë si dhe kompania ndërkombëtare konsulentë (Performance Design Internacional).

Ky projekt financohet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zhvillim ndërkombëtar (USAID).

Nevoja për një koordinim të tregut të punës me sistemin arsimor

Ajo çka është evidente është se me gjithë progresin e arritur në këtë drejtim sistemi arsimor në Kosovë ende është larg standardeve bashkëkohore të kërkuara. Nëse ndalemi dhe e vështrojmë gjendjen e tanishme të arsimit në Kosovë përkatësisht një aspekt të rëndësishëm në arsimin në Kosovë si tërësi, nivelin e studentëve respektivisht nivelin e njohurive që studentët përfitojnë gjatë studimit të tyre në Universitetin e Prishtinës si dhe gatishmërinë e tyre për të ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës shohim se nevoja për ndryshime pozitive në këtë drejtim është mëse prioritare.

Natyrisht rol të rëndësishëm në përgatitjen e studentit luajnë edhe kushtet ekonomike dhe socialo-politike, mirëpo, faktori kryesor i cili luan rol vendimtar në tërë këtë proces është niveli i lartë arsimor përkatësisht cilësia e studimeve të ndjekura nga studenti. Edukimi, aftësitë si dhe përgatitja arsimore personale të cilën e posedon punëkërkuesi, në këtë rast studenti janë elemente të cilat janë shumë domethënëse për punësimin apo mospunësimin në ndonjë institucion përkatës.

Prandaj është mese e nevojshme që të kemi një koordinim në mes të tregut të punës në njërën anë si dhe sistemit arsimor, pjesë e së cilit është edhe studenti në anën tjetër. Reformimi i sistemit arsimor në Kosovë duhet të shkoj në mënyrë paralele dhe në përputhje të plotë me kërkesat e tregut të punës, çka do të ndikonte edhe në ekuilibrimin e kërkesës dhe ofertës për punë.

Rol të rëndësishëm në avancimin e njohurive të studentit si dhe gatishmërinë e tij për punë do të kishte edhe kryerja e punës praktike në ndonjë nga institucionet përkatëse në përputhje me drejtimin profesional të studentit. Puna praktike do të shërbente si urëlidhëse në mes të studentit dhe tregut të punës e cila njëkohësisht varësisht prej suksesit të treguar nga studenti do të rezultonte edhe me punësim të tij në atë institucion.

Një mbarëvajtje të mirë të tërë këtij procesi do të siguronte fleksibiliteti i sistemit arsimor si dhe vlerësimi kontinuel i plan-programeve mësimore ndaj ndryshimeve pozitive dhe në bashkërendësi të plotë me tregun e punës. Përmirësimi i këtij procesi do të varej edhe nga ngushtimi i hapësirës vepruese të nepotizmit (familjarizimit) si dukuri e cila ka në shoqërinë kosovare është shumë e përhapur dhe si e tillë po rezulton edhe me kualitetin dhe efikasitetin e shërbimeve publike në vendin tonë, për arsye të vendosjes së njerëzve jorelevant në pozitat udhëheqëse përkatëse.

Këto ditë ka filluar implementimi i projektit për përmirësimin e performancës të Universitetin e Prishtinës. Qëllimi i këtij projekti është që të ndihmohet UP-ja të dizajnoj organizatën, procesent e saj dhe funksionet në një mënyrë më efikase, në përpjekjet e që t'i arrij standardet ndërkombëtare. Partner të përbashkët implementues të këtij projekti janë: Universiteti i Prishtinës, World Learning- zyrës në Kosovë si dhe kompania ndërkombëtare konsulentë (Performance Design Internacional). Ky projekt financohet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zhvillim ndërkombëtar (USAID).

Me shkas

INTEGRIMI EVROPIAN KALON NGA BASHKIMI SHQIPTAR



Koço DANAJ


Fillimisht vetëm për kujtesë: Sipas statistikave, në Ballkan afër 9 milionë grekë, që të gjithë jetojnë në një shtet që quhet Greqi. Përsëri sipas statistikave, në Ballkan afër 8 milionë serbë jetojnë në një shtet në Serbi dhe të tjerët në Bosnjë e në Kosovë. Dhe duke vazhduar me statistikat, rreth 8 milionë shqiptarë që jetojnë në Ballkan kanë këtë shpërndarje: 3.5 milionë jetojnë në një shtet që quhet Shqipëri, 2 milionë jetojnë në një protektorat që quhet Kosovë, 100 mijë jetojnë në një shtet tjetër në Serbi, 700 mijë jetojnë në një shtet tjetër në Maqedoni, 60 mijë jetojnë në një shtet tjetër në Mal të Zi, afër një milion jetojnë në Greqi dhe afër 500 mijë në Itali.

Jo vetëm për kujtesë, por edhe analizë

Dhe për t'u bërë më konkret, duhet thënë se qytetarët grekë punojnë për begatinë dhe zhvillimin e Greqisë dhe të vetes së tyre. Qytetarët serbë në shumicë dërrmuese punojnë për zhvillimin e Serbisë dhe të vetes së tyre. Ndërsa shqiptarët janë më ndryshe; gjysma e tyre punon për Shqipërinë dhe për veten e tyre, 2 milionë që jetojnë në Kosove punojnë për protektoratin e OKB-së, ata që janë brenda shtetit maqedonas punojnë për zhvillimin e një shteti tjetër, siç është Maqedonia. Shqiptarët e Luginës së Preshevës punojnë për zhvillimin e një shteti tjetër, siç është Serbia. (Trojet e mija, shteti i tjetrit). Pra, kemi një thyerje, kemi të bëjmë me një paradoks unikat. Duke lënë jashtë analizës atë që quhet emigracion ekonomik apo diasporë, kemi të drejtë të themi: Përse kjo padrejtësi? Përse nga 8 milionë shqiptarë, vetëm 3.5 punojnë për Shqipërinë, ndërsa të tjerët punojnë për OKB, për Serbinë, për Malin e Zi, për Maqedoninë? Pyetja është e drejtë, përgjigjja ka qenë dhe mbetet e padrejtë.

Fuçi-baruti apo oazë mirëqenie

Është i njohur nga ata që merren me ballkanistikën, nocioni politik Ballkani-fuçi baruti. Dhe në qoftë se bëjmë një analizë të pjesshme të shekullit që sapo shkoi dhe ngjarjeve të tij, arrijmë në konkluzionin se nocioni "Ballkani-fuçi baruti" ka lindur nga artificialiteti i shteteve që janë fqinjë me Shqipërinë. Ai ka lindur nga paradoksi i shekullit të 20-të, sipas të cilit vetëm kombi shqiptar ka fqinj veten e tij. (Kosova është precedentë, thonë shumë syresh. Por harrojnë se precedenti më i madh i kësaj bote është kombi shqiptar. Është i vetmi komb që ka fqinj veten e tij. Gjejeni një tjetër të tillë). Kufijtë e Shqipërisë me shtete të tjera të Ballkanit nuk janë natyralë, janë artificialë. Ashtu si edhe territoret e disa shteteve fqinjë nuk janë plotësisht natyralë, por kanë edhe artificialitet brenda tyre. Dhe ky artificialitet shfaqet hapur kur disa nga këto shtete kanë territore dhe popull shqiptar brenda tyre. Shikoni se çfarë ndodh: Maqedonia zhvillohet me kontributin e maqedonasve, por edhe me mendjen dhe trojet e shqiptarëve, siç është fusha e Pollogut. Greqia zhvillohet me kontributin e grekëve, por edhe me pronat e shqiptarëve të Çamërisë. Serbia zhvillohet me kontributin e serbëve, por edhe me mendjen dhe trojet e shqiptarëve. Ky është një realitet, pse ta fshehim. Fshehja është mashtrim. Ky mashtrim zgjati afër një shekull. Nuk mund të zgjasë më, sepse edhe atë e kanë kuptuar të gjithë.



Qarjet nuk zgjidhin asgjë

Shqiptarët kanë 95 vjet që shkruajnë dhe flasin se shpallja e pavarësisë së Shqipërisë aktuale, ishte edhe tragjike, pasi la jashtë shtetit, gati gjysmën e hapësirave dhe popullit shqiptar. Qytetarë, shtetarë, gazetarë, historianë, politikanë përgjatë këtyre 95 vjetëve kanë pohuar pohimin e sipërthënë. Por edhe politikanë, qeveritarë apo gazetarë të huaj kanë qenë dakord me anën tragjike të krijimit të shtetit shqiptar. Pra, kanë pranuar se veç "haxhiqamilëve" shqiptarë që ishin injorantë, kanë pasur edhe ata haxhiqamilët e tyre, që nuk ishin injorantë. Haxhiqamilizmi nuk barazohet vetëm me injorancën. (Nuk është haxhiqamilizëm të kërkosh vetëm "babën", por është haxhiqamilizëm edhe kur të ndajnë nga nëna dhe të japin me zor Vojvodën për "Burrë"). Dhe duket se bashkësia ndërkombëtare është duke rregulluar gabimet e saj. Kemi të bëjmë me një Drejtësi të Vonuar. Por, duhet të pohojmë se ajo lypset të mos jetë Drejtësi e Cunguar. Dhe për të mos qenë e tillë, politika shqiptare duhet të ndryshojë. Bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht SHBA, kërkon partnerë. Politika shqiptare nuk duhet të jetë pengesa kryesore e kombit nga i cili ka dalë. ("Jo me Serbinë, por me Shqipërinë" do të shprehej europeisti i madh shqiptar nga Gjilani, Ramiz Cërnica, në Kuvendin e Prizrenit në vitin 1945, Kuvend që gjoja vendosi "bashkimin" e Kosovës me Jugosllavinë. "Të hapur ndaj Serbisë dhe Shqipërisë", shprehen disa politikanë shqiptarë gjoja globalistë dhe integristë në Prishtinë. Domethënë që Shqipëria na qenka e barabartë me Serbinë!! Po ata vetë çfarë janë?! Dhe e thonë këtë kur SHBA pret që të thonë më shumë, të paktën të thonë atë që thoshte Ramiz Cërnica, ose atë që kishte të shkruar në betim luftëtari i UÇK-së).



Artificializmi në ndërtimin e shteteve është destabilizuesi më i madh jo vetëm i atij shteti, por edhe i gjithë rajonit. Ballkani është destabilizues, sepse është rajon artificial. Dhe synohet akoma nga disa shtete evropiane të mbahet i tillë, për ta pasur destabilizimin të kontrolluar. Janë vetëm SHBA që fare hapur kërkojnë natyralitetin e tij. Dhe natyralitet do të thotë që shqiptarët të mos jenë gjysmakë. Sa kohë që shqiptarët do të vazhdojnë të jenë në 5 shtete, aq kohë Ballkani do të jetë fuçi-baruti. Sepse për aq kohë, shtylla kurrizore e rajonit do të jetë "e krisur" në qendrën e saj. (Osam, Dheka, 3.5 është një shtyllë kurrizore e krisur).

Vendi yt është Shqipëria

Një pjesë politikanësh shqiptarë përpiqen ta fshehin ruajtjen e artificialitetit rajonal me gjoja ekzistencën e traditave, të integrimit, status quosë etj. Sipas tyre, Maqedonia është edhe vendi i shqiptarëve, pasi atje ata kanë varret e të pareve të tyre. Nuk është as logjikë etnike dhe as historike, është thjesht propagandistike. Është për t'u shtirur. Është fshehja e pafuqisë për të bërë më shumë. Pse? Sepse, varret nuk janë tregues se i kujt është vendi. Turqia nuk është vendi i shqiptarëve, megjithëse në Turqi me mijëra shqiptarë kanë varret e të parëve të tyre. As Greqia nuk është vendi i shqiptarëve, meqë edhe në Greqi me mijëra shqiptarë kanë varret e të parëve të tyre. Republika e Maqedonisë ka brenda territorit të saj një pjesë të konsiderueshme territoresh që nuk janë maqedonase, por janë shqiptare. Ato janë pjesë të Shqipërisë Natyrale, që për njëmijë e një arsye i janë shkëputur asaj. (Atdheu i Mehmet Pashë Dërrallës nga Tetova ishte Shqipëria, ai ishte ministër i qeverisë së parë të Ismail Bej Vlorës. A ka sens që gjoja në emër të globalizmit t'i thuash kujtimit të atij apo stërnipërve të tij se atdheu i Dërrallës është Maqedonia?)

Lypset të mësohet nga kryeministri grek Karamanlis, që në mes të Këshillit të Evropës, deklaroi përpara Mitrevës: "Unë Konstantin Karamanlis jam maqedonas dhe bashkë me mua janë të tille edhe 2.5 milionë grekë të Maqedonisë së Egjeut". Pra, ai synoi t'u mohojë maqedonasve jo vetëm emrin, por edhe kombësinë dhe askush nuk i tha asgjë. Ndërsa internacionalistët tanë kanë frikë të kërkojnë edhe emrin e tyre!

Integrimi evropian kalon nga bashkimi i shqiptarëve

Sa kohë që shqiptarët në rajon do të jenë në gjendjen e sotme, aq kohë rajoni do të jetë i pastabilizuar. Por për këtë përgjegjësia nuk do të jetë e tyre. Ndërsa Shqipëria do të jetë e pazhvilluar dhe për këtë pazhvillim të saj, lypset që përgjegjësia të kërkohet te vetja. Zhvillim do të thotë bashkim. Gjendja e sotme me raportin 8 milionë serbë në një shtet, 10 milionë grekë në një shtet dhe vetëm 3.5 milionë shqiptarë në një shtet, ka dhe do të ketë destabilizim, ka dhe do të ketë moszhvillim të shqiptarëve. Integrimi evropian kalon nga bashkimi. Askush nuk mund t'u thotë shqiptarëve pse kërkojnë të drejtën e tyre, pse kërkojnë zhvillimin e tyre.

PAVARËSIA E ADOLESHENTIT, SFIDË E MADHE

Pjesa më e madhe e adoleshentëve e kuptojnë pushtetin e tyre duke kundërshtuar autoritetin (prindin). Për prindin i cili e gjen vetën e tij në një situatë të vështirë, ku çdo fjalë që po e thotë është gabim dhe çdo këshillë që po e jep është e dyshimtë, kjo mundë të jetë diçka e lodhshme. Situata bëhet më e lehtë, kur kuptoni qëllimet e adoleshentit, dhe reagoni në mënyrë të duhur



Arber ZEKA

Fëmija i vogël fillon të rritet, hormonet janë gati të shpërthejnë, trupi nis të ndryshojë, rriten ndjesitë seksuale dhe hapët një kapitull i ri, në jetë. Fëmija juaj fillon të zhvillohet, dhe ngjashëm si edhe trupi i tij andaj, ai fillon të përjetoj ndjesi të reja.

Është kjo, një nga fazat e zhvillimit të njeriut, por faza më e rëndësishme, faza ku vihen themelet e një personaliteti, si dhe një ndër fazat fillestare, nga e cila edhe më së shumti vijnë problemet, është pra faza e adoleshencës.

Adoleshencë do të thotë një pjesë e personaliteti të individit, që zhvillohet në fazën e pubertetit, shkëputet nga familja në kërkim të identitetit, gjithnjë në zbulim të anëve të forta dhe të dobëta të karakterit të tij, shpesh rebelohet duke mos qenë edhe aq i sigurt në vetveten.

Pyetjet më të shpeshta që sillen në kokën e një adoleshenti

Detyra parësore e adoleshentit është të zbuloj së kush është ai si një individ. Cilat janë vlerat e tij apo të saj? Çfarë vendi ka në shoqëri? Si ta trajtoi këtë trup të ri i cili po ndryshon? A ka kufi të lejuar? Cilët janë këta kufij? E shumë pyetje të tjera të cilat sillen në kokën e adoleshentit, për të gjetur një përgjigjeje të duhur, dhe që ja vlen.

Për të gjetur një përgjigje të duhur në këto pyetje, rolin kryesor duhet të luaj prindi. Por jo prindi të jetë, në këtë rast gjykatës apo edhe qortues, por këshilltar dhe sqarues, e mbi të gjitha fëmija ka nevojë të kuptoi prindi i tij, së çfarë po ndodh me ndjenjat dhe trupin e tij.

Problemet që ballafaqohen adoleshentet më to, kanë lidhje më seksin, vetëdijen, kontrollin prindëror, kodet morale ose përshtatjen ndaj normave normale të shoqërisë. Po ashtu është një kohë, kur adoleshentët fillojnë të mendojnë për moshën e rritur, rreth asaj se kush janë ata, si dhe rreth nevojave për jetë. Megjithëse adoleshentet përjetojnë probleme, disa nga ta vuajnë nga një stres ekstrem dhe kanë probleme të renda.

Si të kuptoni se adoleshenti ka rënë në depresion?

Ndryshime në të ngrenë, ndryshime në gjumë (më shumë ose më pak), mungesë e vullnetit dhe e energjisë, shmangie nga shoqëria, humbje e interesit nga aktivitetet e lira, humbje e përqendrimit, rënie nga mësimet e sintome të tjera. E rëndësishme këtu të dihet është, si të veprohet nëse adoleshenti juaj kanë njërin nga këto sjellje. Pyetni së si ndihet. Tregoni së do t'i qëndroni pranë çfarë do që do të ndodh. Ftojeni të flas dhe dëgjojeni më vëmendje. Shpjegojini se jeta mund të ketë të mira por normal janë edhe vuajtjet. E kemi të pa mundur të ju ikim, por mund të i zbusim ato.

Depresioni nuk kalon lehtë, as nuk largohet vetë, por duhet shëruar.

Nëse fëmija juaj adoleshent nuk tregon shenja të shërimit, atëherë është e udhës që të kërkoni ndihmën e një psikologu (edhe pse tek ne është një bindje, e keqe sa i përket psikologut, duhet ta dini së rasti është shqetësues, dhe pasojat mund të jen të mëdha).

Një problem serioz, i cili po rritet dukshëm është vetëvrasja në moshën e adoleshencës, ku vetëm për gjatë një viti në botë, rreth 5000 adoleshentë kryejnë vetëvrasje.

Në shumicën e rasteve të vetëvrasjeve të adoleshentëve, arsyeja është depresioni dhe ndjenja e tyre se janë të pa dobishëm.

Në rast së adoleshenti juaj, duket se ka rënë në depresion të thellë, dhe shpesh deklaron së nuk ja vlen të jetosh, e veçanërisht nëse zë në gojë vetëvrasjen, merreni seriozisht dhe kërkoni menjëherë ndihëm te ndonjë psikolog.

Abuzimi më drogë, është një problem i rrezikshëm tek adoleshenca. Përveç alkoolit dhe marijuhanës që janë më të përdorura, kokaina dhe drogat të tjera gjithashtu janë duke u përdorur.

Kriminaliteti dhe krimet gjithashtu janë rritur, në vitet e fundit. Por, megjithatë, shumica e individëve janë në gjendje të i përballojnë më sukses problemet e moshës së adoleshencës dhe të rriten të shëndetshëm.

Shumë prindër në këto raste e kanë të vështirë të flasin më fëmijët e vet. Por gjendja mund të keqësohet edhe më tepër atëherë kur femja bëhet rast i abuzimeve të drogës, alkoolit apo edhe përfshihet në ndonjë krim të organizuar (vjedhje të ndryshme, rrahje etj).

Ndërkaq s'duhet harruar se jo gjithçka përfundon thjesht. E rëndësishme për adoleshentin është, se nga i marrin ata informacionet për jetën dhe problemet, si dhe vuajtjet nga ajo.

**Një problem serioz, i cili po rritet dukshëm është vetëvrasja në moshën e adoleshencës, ku vetëm për gjatë një viti në botë, rreth 5000 adoleshentë kryejnë vetëvrasje.
Në shumicën e rasteve të vetëvrasjeve të adoleshentëve, arsyeja është depresioni dhe ndjenja e tyre se janë të pa dobishëm.**

Adoleshentet fillojnë të ndahen psikologjikisht nga familja. Ndërsa prindërit vazhdojnë të luajnë një rol kyç në jetën e tyre, e gjithashtu edhe shoqëria fillon të zë një vend të rëndësishëm tek ata.
Që të zhvillohet mirë një adoleshent, ai duhet të dal një herë e përgjithmonë nga guaska e fëmijërisë.

Sjellja e prindërve ndaj adoleshentëve

Më kalimin e kohës, prindërit e humbasin kontrollin mbi adoleshentin e tyre. Kur kuptohet së fëmija juaj adoleshent po kërkon pavarësi, ju mund t'i jepni disa mundësi zgjedhjeje, që mendoni se janë më të përshtatshme për të. Kini parasysh atë që është pozitive dhe e dobishme. Kërkoni mendimin e tij, sa herë që të ju jepet mundësia.
Kur nevoja e fëmijës suaj shtohet për pavarësi, kjo është e lidhur edhe me nevojën e tyre për miratimin tuaj. Dhe mos të habitemi së kjo nuk është një nevojë e rëndësishme. Pikërisht miratimi juaj mund ta motivoj atë edhe për punë, por edhe ju i ndihmoni vetës, vendimet e më vonshme do t'i merrni së bashku.
Pjesa më e madhe e adoleshentëve e kuptojnë pushtetin e tyre duke kundërshtuar autoritetin (prindin). Për prindin i cili gjendet në një situatë të vështirë, ku çdo fjalë e tij kuptohet si e gabuar dhe çdo këshillë e tij merret si e dyshimtë, kjo mund të shkaktoj lodhje dhe nervozizëm.
Situata bëhet më e lehtë, kur kuptoni qëllimet e adoleshentit, dhe reagoni në mënyrë të duhur.
Mënyra e duhur, këtu është të kuptohen ndjenjat e adoleshentit, dhe të zgjidhet një rrugë e cila është e përshtatshme për të dyja palët.
Të vendosesh kufij nuk është as një herë e lehtë. Sidomos më adoleshentet është një sfidë e madhe, sepse ata kërkojnë vazhdimisht pavarësi. Kjo është një nga detyrat më të vështira për prindërit në fazën e adoleshencës së fëmijëve të tyre. Pikërisht kur e lejoni fëmijën adoleshent të fillojë të dalë në grup, me një shok apo shoqe, ky do të jetë një vendim i mbështetur në normat tuaja. Dhe ato (normat) shumë lehtë mund të diktohen se janë të mira apo të këqija, pasi që e keqja nga e mira shumë lehtë dallohet. Besojuni normave dhe ligjeve tuaj, si prind.
Nëse mendoni së vajza apo djali juaj adoleshent është tepër e re apo i ri të dal më shok e shoqe, dhe ankohet se je prindi i vetëm që nuk po i lejon të dalin më shokë, se vetëm ata janë duke qëndruar mbyllur në shtëpi, ju mund t'i thoni: më vjen keq që kjo po të mërzit, por nuk mund të të mbështes për diçka që mendoj së është gabim. E më pas shpjegoni arsyen.
Por nëse mendon së ai apo ajo mund të dalë më shokë dhe shoqe, atëherë thuaj së është në rregull, por si prind duhet ta dish së ku është dhe ku shkon, dhe gjithsesi më kë. Ky lloj informacioni se ku dhe më kenë është, është informacion thelbësor.

Kur fillon faza e adoleshencës?

Në përgjithësi djemtë të cilët piqen më herët seksualisht duket se kanë më pak probleme se sa ata të cilët piqen më vonë.
Shumica e psikologëve janë të mendimit së faza e adoleshencës, fillon në kohen e pubertetit (koha kur një individ fillon të piqet seksualisht, duke u bërë i aftë të riprodhohet). Për meshkujt diku rreth moshës 13 vjeçare ndërsa për vajzat rreth 11 vjeç.
Për mbarim të fazës së adoleshencës psikologët nuk bijnë dakord. Por e vërteta qëndron në atë se, koha e zakonshme e mbarimit të saj sillet rreth moshës 18 deri 21 vjeç. Por më gjithat, adoleshenca është një kohë në tranzicion prej varësisë tekë pavarësia dhe përfundon, kur individi arrin statusin e të rriturit.
Sa i përket zhvillimit fizik, si djemtë ashtu edhe vajzat, përjetojnë një rritje të vrullshme gjatë adoleshencës, gjë që shfaqet në mënyrë të dukshme në shtimin peshës dhe gjatësinë e tyre.
Te vajzat rritja e vrullshme fillon nga mosha 8 deri në 10 vjeç, duke arritur kulminacionin rreth moshës 13 vjeçare. Ndërsa tek djemtë, rritja e vrullshme shfaqet nga mosha 10 deri në moshën 12 vjeçe dhe arrin kulmin në moshën 14 vjeç. Gjatë kësaj përudhe si djemtë ashtu edhe vajzat shtojnë një peshë deri 5460 gram. Ndërsa vajzat arrin gjatësinë e të rriturit rreth moshës 17 vjeçe ndërsa djemtë rreth moshës 20 vjeç.
Zhvillimi seksual të femrat është më i hershëm se sa të djemtë, një apo edhe dy vite më herët. Menstruacionet janë shenjë e qartë e pubertetit, dhe rëndom ndodhin në moshën 12 deri 14 vjeç, por mund të ndodh edhe më vonë apo më herët, një luhatje që mund të shkoj nga 10-18 vjet. Afërsisht në ketë kohë bëhet edhe zhvillimi dytësor i seksit, si gjunjët, qimet pupike dhe zgjerimi i eshtrave të legenit.
Ndërsa të djemtë, testikujt dhe penisi fillojnë të rriten rreth moshës 12-13 vjeç. Pak pas kësaj shfaqen qimet pupike dhe kështu një mashkull në moshën 15 vjeç mund të prodhoj spermë.
Karakteristikë dytësore të zhvillimi fizik të djemtë, është zhvillimin e mjekrës, zërin e trash dhe shpatullat zgjerohen.
Në përgjithësi djemtë të cilët piqen më herët seksualisht duket se kanë më pak probleme se sa ata të cilët piqen më vonë. Janë më të populluar, shpesh për arsye të aftësive superiore atletike dhe priren të kenë respekt më të madh për vetën.
Sa u përket vajzave, të dhënat për to duket se janë më pak të qarta. Vajzat adoleshente të pjekura herët, shihen nga moshataret e tyre si të braktisura, madje edhe si të bezdisshme. Por më vonë gjatë shkollës së mesme ato janë më të popullarizuara.
Dhe në fund, ndihmoni adoleshentit të kuptoj që njerëzit bëjnë edhe gabime, dhe nëse adoleshenti juaj bën gabime qortoni gabimin e jo atë. Këshilloni të respektojë të tjerët. Ndihmoni fëmijën tuaj të kuptoi gjerat për së mbari.



Sa i përket zhvillimit fizik, si djemtë ashtu edhe vajzat, përjetojnë një rritje të vrullshme gjatë adoleshencës, gjë që shfaqet në mënyrë të dukshme në shtimin peshës dhe gjatësinë e tyre.
Te vajzat rritja e vrullshme fillon nga mosha 8 deri në 10 vjeç, duke arritur kulminacionin rreth moshës 13 vjeçare. Ndërsa tek djemtë, rritja e vrullshme shfaqet nga mosha 10 deri në moshën 12 vjeçe dhe arrin kulmin në moshën 14 vjeç. Gjatë kësaj përudhe si djemtë ashtu edhe vajzat shtojnë një peshë deri 5460 gram. Ndërsa vajzat arrin gjatësinë e të rriturit rreth moshës 17 vjeçe ndërsa djemtë rreth moshës 20 vjeç.

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

EDHE TRESHJA E GK-së

Demir RESHITI

Kosova ka vazhduar të jetë aktuale në skenën politike botërore, edhe gjatë muajit gusht. Treshja SHBA-BE-Rusi, e përfaqësuar nga diplomatët Frank Wisner, Wolfgang Ischinger dhe Aleksandër Kaharchenko, kanë nisur punën e tyre në formë të së ashtuquajturës "diplomaci fluturuese". Ndërsa në fund të gushtit, kanë organizuar në Vjenë një takim me përfaqësuesit e Prishtinës dhe të Beogradit. Përfaqësuesi rus i Treshes, Aleksandër Botsan-Kharchenko, pas takimit të Vjenës, ka pranuar se bisedimet nuk kanë rezultuar me përafrime qëndrimesh ndërmjet palëve.


Ban Ki Moon

Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe nuk është vërejtur ndonjë ndryshim i qëndrimeve ndaj statusit të Kosovës në radhët e diplomatëve perëndimorë. Derisa diplomatët e SHBA-së dhe të BE-së, kanë vazhduar të përsëritin qëndrimin, se mbështesin pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën, Moska zyrtare vazhdon me kundërshtimin e saj, duke e përsëritur se do ta mbështes vetëm zgjidhjen për të cilën pajtohen Prishtina dhe Beogradi...

Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit gusht 2007.

(1 gusht) Ban Ki-Moon: "Status-quo-ja është e paqëndrueshme"
Nju Jork – "Status-quo-ja është e paqëndrueshme", ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i OKB-se Ban Ki-Moon, dhe ka shfaqur shpresën se bisedimet e reja për Kosovën ,do të çojnë deri të marrëveshja për statusin e ardhshëm të saj.

(2 gusht) Aleksejev: Plani i Ahtisaarit është "i vdekur"
Beograd – Plani i Marti Ahtisaarit për statusin e ardhshëm të Kosovës është "i vdekur" dhe është hequr nga tryeza e bisedimeve, ka vlerësuar ambasadori i Rusisë në Beograd, Aleksandër Aleksejev.

(3 gusht) Wisner: Shtetet e Bashkuara e kundërshtojnë copëtimin e Kosovës
Pragë – S htetet e Bashkuara e kundërshtojnë copëtimin e Kosovës, ka deklaruar për Radion Evropa e Lirë, Frank Wisner, i dërguar i SHBA-ve për statusin e Kosovës. Lidhur me bisedimet shtesë Prishtinë-Beograd, ambasadori Wisner, tha se ato do të jenë bisedime serioze, të cilat do të synojnë ta çojnë rajonin drejt paqes dhe stabilitetit.

(6 gusht) Topi: Institucionet e Tiranës mbështesin plotësisht ato të Prishtinës
Tiranë – Presidenti i ri i Shqipërisë, Bamir Topi tha se statusi i Kosovës duhet të zgjidhet sa më shpejt dhe se institucionet e Tiranës mbështesin plotësisht ato të Prishtinës, në përpjekjet për pavarësinë e Kosovës. Sipas njoftimit të presidencës, Topi i ka bërë këto komente pas takimit me presidentin Fatmir Sejdiu.


Tom Casey


(8 gusht) Casey: Rruga përpara për Kosovën është pavarësia
Uashington – Zëdhënësi i Departamentit amerikan të shtetit, Tom Casey e ka ftuar Prishtinën dhe Beogradin, që në mënyrë aktive të marrin pjesë në rundin e ri të bisedimeve për statusin e Kosovës, megjithëqë, siç ka thënë ai, Shtetet e Bashkuara besojnë se rruga përpara për Kosovën është pavarësia e mbikëqyrur. "Ne besojmë se prap se prap, në fund, rruga përpara për Kosovën është pavarësia, fillimisht e mbikëqyrur, ashtu siç parashihet me planin e Ahtisaarit", u tha Tom Casey gazetarëve në Uashington.

(10 gusht) Ischinger: Plani i Ahtisarit është ende në tryezë
Londër – I dërguari i Bashkimit Evropian, Wolfgang Ischinger ,tha pas takimit të treshes ndërkombëtare se plani i Kombeve të Bashkuara, që Kosovës i jep pavarësi nga Serbia, është ende aktual. Ischinger u tha reporterëve se "nuk është detyrë e treshes që të bëjë propozime të reja" dhe shtoi se është fakt se plani i Ahtisarit është në tryezë.

(12 gusht) Kather kërkon zgjidhje të shpejtë për statusin e Kosovës
Berlin – Komandanti i KFOR-it në Kosovë, Roland Kather, ka ftuar treshen ndërkombëtare që sa më shpejtë të arrijë zgjidhjen për statusin e Kosovës, për shkak të qytetarëve të Kosovës dhe të ardhmes së tyre.
Pavarësisht se a bëhet fjalë për pakicën serbe, apo shumicën shqiptare në Kosovë, "njerëzve u duhet ky vendim në mënyrë që ta kenë të qartë ardhmërinë e tyre", i ka thënë gjenerali Kather radios kombëtare gjermane, DLF.

(15 gusht)
Moskë – Vendet perëndimore, po e lejojnë Kosovën që të përdorë kërcënimin me kaos, si shantazh për ti detyruar që të njihet pavarësia e Kosovës. Kështu, ka bërë të ditur ministri i Jashtëm i Rusisë Sergei Lavrov.

(16 gusht) Ichinger: Treshja është pajtuar se do të pranohet çfarë do rezultati për të cilin do të bien dakord palët


Roland Kather

Berlin – Përfaqësuesi i Bashkimit Ev-

NË PRAG TË DËSHTIMIT...

ropian në negociatat për statusin e Kosovës, Vofgang Ichinger ,ka deklaruar se bazë e punës së treshes negociatore është rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit dhe parimet e Grupit të Kontaktit, në të cilat përjashtohet ndarja e Kosovës. Megjithatë, Ichinger në një intervistë për gazetën "Sudeutsche Zeitung" ka thënë se "risia qëndron në atë se treshja është pajtuar se do të pranohet çfarë do rezultati për të cilin do të bien dakord palët".

(19 gusht) Kharchenko: Ende është e mundshme të negociohet një zgjidhje për Kosovën
Pragë-Përfaqësuesi rus në treshen negociatore, Aleksandër Botsan Kharchenko sot shfaqi bindjen se ende është e mundshme të negociohet një zgjidhje për Kosovën.
Kharchenko i tha servisit rus të Radios Evropa e Lirë, se ai u është qasur bisedimeve të reja për Kosovën nga perspektiva se "asgjë nuk është e pamundur".

(22 gusht) Burns: Kosova do të duhej të ishte e pavarur në vitin 2007
Uashington – Nënsekretari amerikan i shtetit, Nicholas Burns tha sot se Kosova do të duhej të ishte e pavarur në vitin 2007. "Ne po përpiqemi shumë fuqishëm ta mbështesim propozimin që Kosova të jetë e pavarur në vitin 2007. Ky është pozicioni i vendit tonë", ka deklaruar Burns gjatë një bisede me gazetarët e Radios Evropa e Lirë.
Londër – Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian në negociatat për statusin e Kosovës, Vofgang Ichinger i ka hedhur poshtë deklarimet se Brukseli është për


Nicholas Burns

ndarjen e Kosovës. Ichinger ka thënë se ndarja nuk është diskutuar dhe se nuk është opsion real.
Në një intervistë për gazetën britanike "Guardian", diplomati gjerman ka thënë se ndarjen nuk e kanë paraqitur asnjëra palë në bisedimet për statusin.

(23 gusht) Kharchenko: Arritja e kompromisit është "pabesueshmërisht e vështirë"
Moskë – Rusia ka pranuar se arritja e kompromisit, midis shqiptarëve dhe serbëve në rundin e ri të bisedimeve për statusin e Kosovës është "pabesueshmërisht e vështirë". Komentet janë bërë nga i dërguari rus në bisedime Aleksandër Kharchenko.

(27 gusht) Sarkozy: Mbështesim parimin për pavarësinë e mbikëqyrur
Paris – "Ne mbështesim parimin për pavarësinë e mbikëqyrur, të cilën me ndihmën e BE-së ,do ta zbatojë bashkësia ndërkombëtare, garantuese e respektimit e të drejtave të pakicave", ka thënë presidenti francez, Nicholas Sarkozy para ambasadorëve të Francës në botë.

(28 gusht) Wordsvorth: Plani i Ahtisarit, "ende është në tavolinë"
Beograd – Ambasadori i Britanisë së


Nicholas Sarkozy

Madhe në Beograd Stivën Wordsvorth, ka deklaruar sot se plani i të dërguarit të posaçëm të OKB-së për Kosovën Marti Ahtisari, "ende është në tavolinë". Wordsvorth u ka thënë gazetarëve në Beograd, që shpreson se palët do të angazhohen seriozisht në vazhdim të bisedimeve për të gjetur një zgjidhje për Kosovën.

(29 gusht) Jung: Gjermania dhe Kroacia mbështesin pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën
Zagreb – Gjermania dhe Kroacia, mbështesin pavarësinë e mbikëqyrur për Kosovën, ashtu siç parasheh plani i Ahtisaarit, ka deklaruar në Zagreb, Ministri gjerman i mbrojtjes, Francë Josef Jung. Këtë deklaratë Jung e bëri pas takimit me homologun kroat, Berisllav Rončeviq.

(30 gusht)Vjenë: Mbahet raundi i parë shtesë i bisedimeve Prishtinë-Beograd
Vjenë – Ndarja e Kosovës nuk është opsion as për Kosovën e as për Serbinë, dhe nuk është në agjendën e përpjekjeve të fundit për kompromis midis palëve, ka deklaruar pas takimit në Vjenë i dërguari i BE-së, Wolfgang Ischinger. Ai i ka bërë këto komente pas raundit të parë të bisedimeve shtesë Prishtinë-Beograd


Wolfgang Ischinger

për statusin e Kosovës.
Ndërkaq anëtari tjetër i Treshes, Aleksandër Botsan-Kharchenko, ka thënë se takimet e sotme nuk rezultuan me përafrime qëndrimesh, gjë që as nuk është pritur.
Vjenë-Ministrja e punëve të Jashtme të Austrisë Ursula Plashnik, ka deklaruar se 10 dhjetori është afati i fundit i zgjidhjes së statusit të Kosovës dhe se kjo çështje nuk mund të shtyhet në pafundësi.

(31 gusht) Ischinger: Vështirë se do të mund të arrihet marrëveshja
Vjenë – Pas përfundimit të bisedimeve doemos duhet të merret vendimi i përhershëm për statusin e Kosovës, ka deklaruar për gazetën austriake "Standard", përfaqësuesi i BE-së në treshen ndërmjetësuese, Wolfgang Ischinger.Ai, ka thënë se vështirë se do të mund të arrihet marrëveshja gjatë fazës 4 mujore të bisedimeve shtesë. Ischinger ka përjashtuar mundësinë e ndarjes së Kosovës dhe ka shtuar se "do të ishte katastrofike nëse do të lejonim që çështja e Kosovës të përçajë Bashkimin Evropian.

Problemet në bujqësinë e Kosovës

BUJQIT FAJËSOJNË QEVERINË

Ankesat e bujqve janë të mëdha, duke filluar nga çmimet e ulëta e deri të mosinteresimi i qeverisë për t'i ndihmuar. Ata shprehin mllefin e tyre ndaj qeverisë që nuk po tregon interesim për ta.
Pothuajse të gjithë bujqit me të cilët biseduam, i ngritin të njëjtat shqetësime dhe drejtojnë kritikat në adresë të qeverisë, e cila me politikën e saj jo vetëm që nuk po e ndihmon këtë kategori prodhuesish, por po u nxjerr vështirësi



Osman D. GASHI

Ndër problemet e shumta, me të cilat po përballet Kosova, është edhe çështja e bujqësisë apo e agrikulturës.

Kosova ka kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, pasi që toka pjellore që e ka, e bën një prej vendeve të cilat jo vetëm që mund t'i plotësojë nevojat e veta me prodhimet bujqësore por ka kapacitete që një pjesë të atyre prodhimeve t'i eksportojë në vende tjera.

Kosova me, me sipërfaqen e saj prej 10,908 km2 përbëhet nga dy fusha tektonike; Fusha e Kosovës me një lartësi mbidetare prej 500 – 570 metra dhe Rrafshi i Dukagjinit me lartësi mbidetare prej 300 – 450 metra.

Përparësia e kushteve më të mira klimatike e Rrafshit të Dukagjinit se sa e Fushës së Kosovës, e bën të parin që të merret me agrikulturë më shumë se sa ky i dyti. Përparësi është edhe funksionimi i sistemit të ujitjes së hidrosistemit "Radoniqi" i cili e mbulon shumicën e territorit të Rrafshit të Dukagjinit.

Sidomos, në Rrafshin e Dukagjinit, zona e Anadrinisë është ajo që merret më së shumti me agrikulturë, e posaçërisht me prodhimin e perimeve përfshirë këtu: specat, domatet, patatet, lakrat, trangujt, e produkte tjera që përdoren për ushqim të njerëzve, e po ashtu edhe të kafshëve.

Agrikultura apo bujqësia është një fushë e ekonomisë e cila për t'u marrë me të do aktivitet dhe mund fizik, është një 'zanat i randë' siç thotë populli, dhe po nuk pate nxitje financiare dhe përfitim prej saj është edhe më vështirë që të merresh me këtë 'zanat'.

Bujku, kur punon, prodhon. E prodhimet e tij, i nxjerrë në treg për t'i shitur, në mënyrë që të përfitojë prej prodhimeve të tij, e me ato para që fiton ta sigurojë ekzistencën e familjes së tij.


REXHEP REXHEPI

Cilat janë hallet e bujqve të Anadrinisë?

Ne i vizituam dy tregje në rajonin e Anadrinisë, në Krushë të Madhe dhe në Xërxë të komunës së Rahovecit dhe biseduam me bujq që kishin nxjerrë prodhimet e tyre në treg për t'i shitur.

Pothuajse të gjithë bujqit me të cilët biseduam, i ngritin të njëjtat shqetësime dhe drejtojnë kritikat në adresë të qeverisë e cila me politikën e saj jo vetëm që nuk po e ndihmon këtë kategori prodhuesish, por po u nxjerr vështirësi.

Rexhep Rexhepi: Jam pishman që kam mbjellë sivjet speca

Bujku Rexhep Rexhepi, nga Celina e Rahovecit, thotë se përballet me vështirësi të shumta, që nga mbjellja e deri në pasimin në treg të prodhimeve.

"Sivjet, i kam pasur 60 ari të mbjella me spec dhe 25 ari me tranguj. Vështirësi kemi pasur gjatë prodhimit për shkak të kushteve klimatike sepse ka qenë një verë shumë e nxehtë dhe e thatë, kështu që rendimentet nuk janë aq të kënaqshme. Sa i përket çmimit sivjet, është më i lirë për 50% në krahasim me vitin e kaluar", thotë Rexhepi.

Në pyetjen tonë, se a i ka ndihmuar diçka Ministria e Bujqësisë apo qeveria, Rexhepi u përgjigj: "jo, (nënqeshet) nuk na ka ndihmuar me asgjë, as me plehra, as farëra, e asgjë tjetër që neve si bujq na duhet. Jam pishman që kam mbjellë sivjet speca, po ta dija ndonjë zanat tjetër me kënaqësi do ta braktisja bujqësinë".

Rexhepi thotë se zgjidhjen e këtij problemi e sheh në krijimin e kushteve për shitjen e specave jashtë Kosovës, dhe për këtë e bën përgjegjës qeverinë. "Qeveria jonë nuk mendon për neve aspak...', thekson Rexhepi duke shpre-

hur shpresën se një ditë do të bëhet më mirë.

Fazli Ramadani: Sivjet çmimi më i ulët për 50 për qind

Të njëjtin mendim me Rexhepin e ndanë edhe bujku nga Krusha e Madhe, Fazli Ramadani. "Sivjet jam i kënaqur me sasinë dhe cilësinë e produkteve të mija që i kam mbjellë, por me çmim aspak nuk jam i kënaqur pasi sivjet në krahasim me vitin e kaluar çmimi është për 50% më i dobët", thotë Fazliu, duke shtuar se ka pas raste kur një thes me speca e ka shitur për vetëm 30 centë!

"Tregtarë të cilët po vijnë me na i ble mallin tonë po ka, por edhe ata po mundohen të shkretit me fitu diçka e çmimi po asht shumë i dobët. Ka pasur raste kur kemi shitë edhe nga 30 cent rrjetën me speca, 10 cent ka kushtuar rrjeta, pra, na ka ra qe një rrjetë me speca me e shitë për 20 cent", shpreh shqetësimin e tij Fazliu.

Edhe ky bujk i fajëson qeveritarët, që sipas tij po interesohen vetëm për vete. "Qeveria i ka fajet!... Ajo nuk interesohet për ne, ata atje në Prishtinë interesohen vetëm për vete, si të pasurohen vet, e për popull qysh duan vetë le t'ia bëjnë", thekson Fazliu, duke shtuar se po të kishte ndonjë zanat tjetër, do ta braktiste bujqësinë.

Një rrugëdalje nga kjo gjendje e krijuar ky bujk i vyeshëm e sheh në pasimin e prodhimeve bujqësore jashtë Kosovës. "Mu kon mu hap kufini me Shqipninë dhe Malin e Zi, nashta ishte rritë çmimi i specave e i gjanave tjera që na i shesim, sepse kur po vijnë tregtarë nga Shqipnia me ble speca këtu te na, po na ankohen se shumë pare po ju marrin në kufi, në doganë, a me sa di unë, sa kam nie, Kosova ka të nënshkruar marrëveshje me Shqipërinë që mos me pas doganë për mallna", thekson Fazliu.

Ky bujk tregon se në pranverë është detyruar të marr kredi për të blerë farishte, plehra, e gjëra tjera, por për fat të keq ende nuk i ka nxjerrë shpenzimet.




Gani Thaçi : Shteti e ka për detyrë që të na e mundësojë shitjen e produkteve jashtë Kosovës

Bujku Gani Thaçi nga Xërxa e Rahovecit, mendon se shteti ka për obligim që t'ua mundësojë bujqve pasimin e prodhimeve të tyre në tregun e jashtëm.


GANI THAÇI

"Sivjet prodhim kemi pas mjaft, por çka na duhet kjo kur hiç s'po shkojnë, nuk ka kurrfarë çmimi, tregtarë që po vijnë me ble, nuk po ka sa duhet, edhe ata që po vijnë këtu brenda Kosovës po i shesin me çmim shumë të lirë, nuk po munden me i shitë specat jashtë Kosovës se atëherë do të rritej çmimi e do të bëhej më mirë për të gjithë", thotë Ganiu duke shtuar se investimet e bëra në bujqësi nuk janë të sigurta. "Vet po duhet me i bo të gjitha, po duhet me e ble farën, najlonin, plehun kimik, tokë po duhet me marrë me qira, po duhet me shti pare shumë në fillim, e kur po



vjen puna me i fitu kto pare, shumë problem derisa po i fitojmë, askush s'po na ndihmon... Shyqyr zotit që nuk po bie ndoni breshën a ndoni erë e fortë, se kishim mbet me gishta n'gojë", shpreh shqetësimin e tij ganiu.

Pyetjes sonë se si e mendon zgjidhjen e këtij problemi dhe shitjen e prodhimeve me çmim real, Ganiu i përgjigjet: "Po shteti e ka për detyrë që me na mundësu neve si bujq që prodhimet tona me i shitë edhe jashtë Kosovës e jo vetëm brenda saj. Duhet me ehap edhe ndoni grumbullues tjetër të perimeve siç është "Abi & Elif 19", ish-"Progresi" në Prizren.

Kush ka të drejtë, bujqit apo MBP-ZHR-ja?

Ankesat e bujqve janë të mëdha, duke filluar nga çmimet e ulëta e deri te mosinteresimi i qeverisë për t'i ndihmuar. Ata shprehin mllefin e tyre ndaj qeverisë që nuk po tregon interesim për ta.

Në një kumtesë për gazetarë të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), shkruan se kjo ministri, me politikat e saj ka arritur që të ndryshoj politikat doganore sipas një rregulloreje të UNMIK-ut, e në anën tjetër, bujqit thonë që tarifat e larta doganore ua pamundësojnë tregtarëve të Shqipërisë që të vijnë dhe të blejnë mall e produkte bujqësore në Kosovë.

Se cila palë ka të drejtë në këtë rast, le të gjykojnë vetë lexuesit.

A PO RRËNOHET QEMALIZMI NË TURQI

Paraqitja e serishme e ushtarakëve turq në skenë për të ndaluar Abdullah Gyl të zgjidhet president i vendit mbase është shembulli më i mirë se në Turqi koha e qemalizmit ka perënduar. Cili do të jetë raporti i rendit të ri në botë mbetet të shihet se si do të hapërojnë evropianët në një të ardhme të afërt

Mehmet SHKËMBI

Bota e para disa shekujve ishte e përbërë prej më pak se dhjetë perandorive. Njëra prej këtyre perandorive ishte edhe ajo e kalifatit osman. Ndërsa popujt e shekullit njëzet i njehin si turq. Në fakt kush janë turqit?

Turqit nëpër histori

Mongolia, gjegjësisht tokat përreth liqenit Bajkal është vendi prej të cilit vërshuan turqit nëpër shumë vende të botës. Fiset turke njiheshin si blegtorë. Dihet se blegtorët nuk qëndrojnë në një vend, ata lëvizin nga një vend në një vend tjetër. Si nomadë ata nuk duhet të kishin një traditë të qëndrueshme përveç asaj të rrëmbimeve dhe plaçkitjeve. Aty ku mendonin se vendorët janë të dobët, ose të pa organizuar, aty bëheshin edhe sulmet befasuese. Për një kohë relativisht të shkurtër, rrugëtimi i rrëmbimeve dhe plaçkitjeve, këto fise i spostoi në tokat e Persisë së sotme. Kur këta arritën në këto vise, shteti islam kishte dy qendra. Bagdadi administrohej nga dinastia e plakur e abasidëve, ndërsa Kordova udhëhiqej nga triufalistët muvahidinë, të cilët kishin rimarrë pushtetin në Spanjë. Që të dy këto dinasti ishin shembulli i botës, këto njiheshin si qytetet më të ndritura të botës, si në kulturë ashtu edhe shkencë. Meqenëse turqit kishin traditë stërvitjet dhe fizikun e kishin të pashëm, shumë prej tyre u punësuar nëpër zyret e administratorëve të dinastisë abasite. Më vonë shumë prej tyre u bënë gardistë në oborrin e Kalifëve. Me rrëzimin e abasidëve, vendin e drejtuan memalukët. Shumica e tyre ishin jo arabë, prej tyre kishte një përqindje jo e vogël turqish. Këta nuk përbënin pjesën e intelektualëve të vendit, por, ishin gjeneralë të shquar. Gjatë sundimit të memalukëve shteti islam sa vinte e rrënohej, në këto rrethana gjeneralët turq e shfrytëzuan rastin dhe përvetësuan botën islame. Arabët e stërlodhur nga keqadministrimi i memalukëve, sundimin turk e pranuan pa kurrfarë rezistence. Gjeneralët turk arritën ta stabilizonin perandorinë nga kryengritjet e shumta në vend dhe kështu mbretëroi paqja dhe siguria në vend për disa shekuj.





Si i njohën Evropianët turqit

Paraqitja e turqve në brigjet e Egjeut, do t'i vonojë ëndrrat evropiane të rikthehen në Jerusalem edhe për shumë shekuj të tjerë. Derisa turqit po avanconin ushtarakisht në lindje, evropianët në anën tjetër ngritshin universitetet e tyre. Turqit nuk kishin traditë të përhapjes së kulturës dhe dijes, krahasuar me arabët. Edhe pse kishin jetuar në mesin e dijetarëve dhe shkencëtarëve të Bagdadit dhe Damaskut ata nuk arritën që ta përcjellin mesazhin e pastër islam në Evropë. Derisa ishte përqendruar ushtria osmane në Ballkan, evropianët në këtë kohë iu rrekën përkthimeve të shumta, në veçanti synonin veprat e dijetarëve dhe shkencëtarëve mysliman të Andaluzisë (Spanjës së sotme).

Humanistët evropian ishin të sfiduar nga inkuizitorët krishterë në njërën anë, dhe, nga ushtria e pa mposhtur turke në anën tjetër. Këta qëndruan larg konfliktit fetar midis krishterëve dhe turqve. Faktet historike tregojnë se në Evropë, traditat e islamit nuk paraqiten ashtu siç duhej t'ishin, gjenerata e re mendon se kemi të bëjmë me një përzierje të traditave me të krishterëve. Se cili ishte shkaku që ato nuk u pastruan gjatë shekujve nuk është tema jonë, por, ajo që na intereson neve duket se turqit në Evropë, gjegjësisht në Ballkan më shumë ishin përqendruar ushtarakisht se sa në përhapjen fesë dhe dijes. Propaganda krishtere ishte e pa pengesa të mëdha, sepse që nga koha e Sulltan Bajazitit ata ishin futur thellë në oborrin e sulltanëve si këshilltarë të tyre. Propaganda ishte aq e vrazhdë saqë turqit (myslimanët) i quajtën barbarë e primitiv, se ata janë anadollak dhe të pa kulturë, se ata urrejnë dijen dhe përparimin etj. Në shekujt XVIII e XIX-të, humanistët evropian arritën të dominojnë kundër të krishterëve vendas, e më pas edhe kundër turqve në fillim të shekullit XX-të.

Koha e Ataturkut

Mustafa Qemali "babai i kombit turk", u shfaq si "shpëtimtari i perandorisë". Ai arriti që t'i dëbonte grekët e italianët nga Azia e Vogël, dhe kështu fitoi

përkrahjen e një grupi të gjerë të elitës turke. Mustafa Qemali me profesion edhe ky ishte ushtarak, por, më vonë e emëruan si ataturk-baba i kombit. Një ushtarak i shkëlqyer kishte arritur ta ndryshojë rrënjësisht programin strategjik kombëtar. Pas shumë peripecive dhe sfidave të shumta, meqenëse kishte marrë fort në duar komandën e ushtrisë turke, ai në vitin 1924 arriti që ta rrëzojë kalifin, dhe ta zëvendësojë shkrimin arab me atë latin. Kështu me këtë vendim, në emër të "zhvillimit dhe përparimit" mbarë popullin brenda një nate e shndërroi në popull analfabetarë. Ndërsa në vitin 1937-të një vit para se të vdiste, kishte ngritur një strategji të bazuar mbi gjashtë parime, të cilat i quajtën qemalizëm. Këto gjashtë parime sipas ushtarakëve turk janë të pa ndryshuara dhe, secila përpjekje për t'i zëvendësuar ato do të ndëshkoheshin pa mëshirë. Republikanizmi, nacionalizmi, populizmi, revolucionarizmi, shekullarizmi dhe etatizmi janë parimet themelore të shtetit të ri turk, këto gjashtë pika janë garantues të moskthimit të teistëve në pushtet.



Ndryshimet e mëdha

Turqit nuk u rreshtuan me asnjë aleancë ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndryshimet e mëdha politike e ideologjike që filluan pas luftës në Evropë domosdoshmërish i prekën edhe turqit. Një prej ndryshimeve më madhore që kanë ndërmarrë evropianët konsideroj se është edhe edukimi fetar në shkollat laike. Ndërsa turqit hapin më të madh të ndryshimit e konsideruan hapjen me opinionin duke lejuar parti të tjera opozitare. Në vitin 1946-të, Partia Demokratike merr pjesë në zgjedhjet e para nacionale. Si duket në Turqi zgjedhjet e lira u shndërruan në ferr të vërtetë, sepse shpesh herë rezultonin me viktima të shumta dhe detyrimisht ato anuloheshin. S'do mend se pasonin arrestime duke përfshirë edhe liderë partiak. Qemalizmi si duket ishte shkaku kryesor i përplasjeve të mëdha në popull, prandaj demokracia në këtë vend do të ishte funksionale vetëm nëse ajo do t'i përshtat ushtarakëve të vendit. Të bazuar në parimet themelore të Ataturkut, në këtë vend janë vrarë me dhjetëra mijëra qytetarë. Turqit nuk pranojnë se në shtetin e tyre jetojnë popuj joturq, mu ashtu si Greqia. Demokracia mbi këto baza është e paqëndrueshme, prandaj siguria kombëtare në këtë vend nuk është asnjëherë stabile.

Midis laicizmit dhe fesë

Disa politikanë në Evropë dolën me programe laiko-fetare para elektoratit. Krijimi partive demokristiane nëpër shumë shtete të Evropës reflektoi edhe në Turqi. I pari i cili paraqiti programin politik me sfond fetarë në këtë vend mund të thuhet se është Nexhmetin Erbakan. Ky politikan kishte studiuar shkencat teknike në Gjermani. Pas disa vite angazhimi, arriti të fitojë zemrat e 23 % të zgjedhësve. Këto vota i mundësuan atij të formojë kabinetin qeveritar. Pas një kohe relativisht të shkurtër u detyrua të jep dorëheqje nga ky post për shkak të prishjes së koalicionit qeveritar, e më vonë të burgoset, sepse na qenka i rrezikshëm. Ky lider do të prishë imazhin e qemalian. Derisa ky lider po vuante dënimet dhe po pengohej nga "drejtësia" turke në arenën politike doli në skenë një sportist i njohur në këtë vend. Taip Erdogan, ishte kryebashkiaku i qytetit të Stambollit. Si i ri, dhe i ndihmuar nga shtresa e re elitare e turqve arriti t'i jep një pasqyrë të pranueshme si islamistëve ashtu edhe laikëve. Idetë e tij u pranuan edhe në perëndim, sepse konsiderojnë se janë analoge me idetë demokristiane në Evropë.

A po rrënohet qemalizmi

Turqia ka paraqitur kërkesën e saj për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE) që prej katër dekadash, por deri më sot nuk ka marrë përgjigje pozitive. Se cilat janë shkaqet e mosanëtarësimit në BE mbetet të shihet në të ardhmen, por një lëvizje e cila pretendon të jetë universale nuk kishte arsye ta vononte kaq gjatë anëtarësimin e turqve.
Kohëve të fundit janë dëgjuar zëra se këta nuk pranohen sepse janë myslimanë. Nëse është kjo e vërtetë atëherë, do të kemi një kufi ndarës midis qeverive me sfond të krishterë dhe të atyre mysliman.
Paraqitja e serishme e ushtarakëve turq në skenë për të ndaluar Abdulla Gyl të zgjidhet president i vendit mbase është shembulli më i mirë se në Turqi koha e qemalizmit ka perënduar. Cili do të jetë raporti i rendit të ri në botë mbetet të shihet se si do të hapërojnë evropianët në një të ardhme të afërt.

POLITIZIMI I INSTITUCIONEVE TË DIJES



Shkelzen RRECAJ

A duhet të jenë të politizuar dijetarët, ndoshta është vështirë që t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje dhe pyetjeve të shumta lidhur me politizimin e institucioneve të dijes.

Pas luftës Kosova është ballafaquar më shumë sfida dhe probleme të natyrave të ndryshme, por, një ndër këto është edhe krijimi i shumë partive në vendin tonë, të cilat medoemos po mundohen që të sundojnë në të gjitha institucionet e vendit. Por, a thua vallë a duhet që institucionet e vendit t'i udhëheqin njerëz pa përvojë, njerëz që nuk i takojnë asaj shkence, njerëz të cilët nuk kanë ide në ato vende ku angazhohen për të punuar. Pse i gjithë ky problem? Çfarë po synojnë të bëjnë? Pse duhen të nxirren jashtë njerëz të cilët kanë shkri dijen në ato vende ku kanë punuar gjatë gjithë jetës.

Shumë studiues në vendin tonë nuk çmohen nga udhëheqësit, nuk u intereson asgjë për ta dhe nuk janë të interesuar që t'i ngritin me lartë, ndoshta që nuk i takojnë atij subjekti politik, atyre njerëzve të politikës.

Kjo që po ndodhë në Kosovë është diçka e tmerrshme, me këto sjellje që i takojnë viteve të pushtuesit serbë të cilët u munduan që t'i mbyllin institucionet e dijës.

Dhe ata e arritën atë qëllim, por, këta mësues e mësuese, arsimtarë e arsimtare, profesorë e profesoresha, nuk e lejuan të ndodhte kjo që ky popull të mbetet analfabet. Por, ata punuan pa kompensim, në shtëpia private vetëm e vetëm që mos të mbetet analfabet ky popull, që të ketë një rini të shëndosh një rini të ditur dhe një kulturë të zhvilluar...

Por, pas gjithë këtyre viteve po ndodh diçka që nuk duhet të ndodhte me studiuesit e letrave shqipe si dhe të shkencave të tjera. Ky politizim nuk është në favor të këtij vendi. Nuk duhet të ndodh një gjë e tillë, por, duhet që të kuptojnë një gjë, që Kosovën nuk e njohin në bazë të pushtetarëve, por e njohin në bazë të luftëtarëve të mëdhenj të kombit tonë, nga shkrimtaret e akademiket dhe në veçanti nga kultura e popullit shqiptar.



Institucionet e dijës nuk duhet që t'i takojnë asnjë subjekti partiak dhe asnjë shoqërie të politizuar, por, duhet që t'i takojnë atyre shkencave që janë të prirë për atë vend të cilët e njohin atë shkencë e kanë atë dije dhe dinë që ta udhëheqin atë institucion.

Por, as dijetarët nuk duhet që t'i takojnë ndonjë subjekti politik, por, duhet t'i takojnë lapsit, librit dhe nxënësve të tyre dhe kështu të kemi më shumë studiues që dinë të shkruajnë për këtë vend dhe që ta njohin kulturën tonë dhe kulturat të tjera dhe ta përhapin më shumë dijen e tyre në vendet e tjera të botës, d.m.th që të kemi më shumë shkrimtar, historian, doktorë dhe shkencëtar të shkencave të ndryshme etj.

Dhe jo t'i qesim në rrugë njerëzit e lapsit, të librave, njerëzit e shkencës. Shpresojmë që kurrë mos të ndodhë një gjë e tillë, duhet që t'i respektojmë më shumë studiuesit tonë dhe ky vend që po shkon drejtë formimit të një shteti të ri në Evropë, që të inkuadrohet si një vend ku ka shkrimtar të mëdhenj, historian, shkencëtar të lëmive të ndryshme që i respektojnë dhe i nderojnë për punën që e bëjnë në vendet ku punojnë.

Dija nuk blihet dija fitohet dhe dijen nuk duhet ta blejmë dijen nuk duhet ta vjedhim por, dijen duhet ta fitojmë me mund duke lexuar me shumë duke u marrë me shumë me studime të ndryshëm, Kosova ka nevojë për më shumë studiues, ka nevojë për më shumë dijetarë dhe duhet të ketë më shumë se kultura e popullit shqiptar nuk është e varfër, nuk i takon një kulture të pa zhvilluar, Kosova ka një kulturë të pasur dhe të zhvilluar por, duhet që të punojmë më shumë për këtë vend për shtetin tonë.

Histori Islame (10)

Betejat e myslimanëve në gadishullin arabik

Meqenëse jeta e Muhammedit s.a.v.s. ishte në rrezik permanent, myslimanët jo vetëm që kujdestaronin shtëpinë e Muhammedit s.a.v.s., por ata tani do të vëzhgojnë terrenin përreth Medinës dhe më gjerë. "Lëvizjet e para ushtarake u ngjasonin ekspeditave vëzhguese, qëllimi i të cilave ka qenë hulumtimi dhe njohja me terrenin e gjerë rreth Medinës, si dhe të gjitha rrugët tjera që të qonin nga Meka. Resulullah s.a.v.s. lidhi marrëveshje armëpushimi me të gjitha fiset që banonin në këto hapësira"



Muhamed Jusufi – KAJOLLI

Në numrin e kaluar thamë se myslimanëve iu lejua lufta, por kjo nuk do të thotë se ata me çdo kusht duhet të luftojnë për të drejtat e tyre. Rregullat e luftës në islam janë cituara në Kur'an dhe në praktikën e Muhammedit s.a.v.s. Në asnjë mënyrë lufta e myslimanëve nuk është shndërruar në uzurpatorë, por lejimi i luftës iu hapi shtegun myslimanëve të sillen me natyrën e njeriut. Përveç hartimit të planprogramit paqësore, tani e tutje do të mund të inkuadrojnë edhe forcën. Drejtësia nuk mund të ngadhënjejë në një shoqëri, pa përdorur forcën. Prandaj ata duhet të përgatiten, të stërviten dhe të mësojnë këtë llojet e shumta të këtij arti.

Shkaqet e betejës së Bedrit

Meqenëse jeta e Muhammedit s.a.v.s. ishte në rrezik permanent, myslimanët jo vetëm që kujdestaronin shtëpinë e Muhammedit s.a.v.s., por ata tani do të vëzhgojnë terrenin përreth Medinës dhe më gjerë. "Lëvizjet e para ushtarake u ngjasonin ekspeditave vëzhguese, qëllimi i të cilave ka qenë hulumtimi dhe njohja me terrenin e gjerë rreth Medinës, si dhe të gjitha rrugët tjera që të qonin nga Meka. Resulullah s.a.v.s. lidhi marrëveshje armëpushimi me të gjitha fiset që banonin në këto hapësira".

I pari që mori flamurin islam ishte axha i Muhammedit s.a.v.s., ai kishte ngjyrë të bardhë. Ai u përcaktua nga Muhammedi s.a.v.s. të vëzhgojë terrenin. Në vendin e quajtur Sejful Bahri, patrulla e Hamzait me tridhjetë bashkëvëzhgues u takua me karvanin e Ebu Sufjanit. Falë një ndërmjetësuesi, i cili i njihte dy palët mirë, nuk ndodhi asgjë. Ka ndodhur që, në disa prej patrullimeve të myslimanëve të shpërthente ndonjë përleshje e vogël, në disa prej tyre kishte edhe të vrarë, sikur ekspedita e quajtur Nahla. Ekspeditat tjera më të njohura të myslimanëve para betejës së Bedrit ishin ato në Rabig, në el Harrar, në el Ebva, në Bevat, në Safvan, në Shul-Ushejret.

Beteja e Bedrit

Muhammedi s.a.v.s. ishte informuar se Ebu Sufjani po përgatiste një udhëtim tregtar të bujshëm. Kështu, kërkoi nga disa as'habë-shokë të tij të shkonin për të shikuar sa është karvani i gjatë. Fatkeqësisht ata nuk arritën ta shohin, sepse kishin kaluar pak ditë, që karvani kishte kaluar andej. Muhammedi s.a.v.s. e dinte mirë se sa mund të vonohej, kur erdhi koha e kthimit ai doli me mbi treqind e trembëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë vullnetarë. Thirrja e Pejgamberit nuk ishte kushtrim për luftë, por, vetëm vëzhgim që kishte për qëllim të demonstronte forcën. Si duket programi tij, ishte provokues por gjithsesi t'iu bënte të tjerëve sidomos mekasve se tani e tutje do ta kenë më ndryshe me të s.a.v.s. Në këtë ekspeditë nuk dolën shumë prej myslimanëve të Medinës, ndërsa në anën tjetër Ebu Sufjani u informua se Muhammedi paska dalë në vëzhgim. Ai nuhati rrezikun që mund t'i kanosej dhe të shkatërrohej pasuria e tij dhe e mekasve, prandaj dërgoi informatorin Mekë të alarmojë gjendjen. Më të dëgjuar lajmin, mekësit u përgatitën për betejë, atyre edhe ashtu iu ishte mbushur mendja që moti, të luftonin me Muhammedin s.a.v.s. Përgatitën një ushtri prej 1300 veta, prej tyre gjashtëqind ushtarë të rregullt të veshur me parzmore, njëqind kalorës dhe deve të shumta.

Ndërsa myslimanët kishin dy kalorës dhe shtatëdhjetë deve. Para se të takoheshin ushtritë para në Bedr, Ebu Sufjani kishte dërguar informatorin e vet, i cili këshillonte ushtrinë mekase të kthehet në Mekë ,sepse karvani tij kishte arritur t'i shmangej një rrugoje e cila nuk kishte lënë gjurmë. Ky lajm përçau ushtrinë, prandaj një numër i mirë e dëgjoi këshillën e Ebu Sufjanit dhe u kthyen për në Mekë. Numri tyre ishte mbi treqind. Mirëpo Ebu Xhehli prijësi i kësaj ushtrie ishte këmbëngulës dhe vazhdoi rrugën për tek puset e Bedrit.

Kjo betejë është përshkruar hollësisht, thuajse çdo detaj është paraqitur nga historianët. Edhe pse myslimanët ishin tre fish më pak në numër, ata të bindur në ndihmën e Zotit fituan betejën. Nga radhët e myslimanëve ranë shehid katërmbëdhjetë vetë ndërsa prej mushrikëve mekas shtatëdhjetë të vrarë dhe po aq të zënë rob.

Vazhdon në numrin e ardhshëm



Agjërimi Ligj i Zotit

Agjërimi e bën njeriun edhe më të pastër në shpirt, atij ia përforcon vullnetin e mirësisë dhe e largon nga veprat e liga dhe të shëmtuara. Në një rast Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "Agjërimi është mbrojtje. Ai që agjëron nuk ia lejon veten të bërtasë e as të flet fjalë të ndyta. Nëse dikush të ofendon, të shanë ose të bën të fjalosesh me dikë tjetër, thuaju: "Unë jam agjërueshëm"

Muhamed Jusufi- KAJOLLI

Agjërimi është një vepër shumë e vjetër e njeriut. Historia njerëzore nuk ka argumente të sakta për fillimin e agjërimit. Njeriu e njohu këtë dukuri që prej kohës kur kërkoi nga Krijuesi ndihmë për udhëzim. Për të mirën e njeriut Ai e obligoi edhe me këtë lloj lutje. Njeriu e kuptoi këtë mesazh Hyjnor dhe ju përmbajt këtij obligimi deri në ditët tona. Njerëzimi duke formuluar shkrime të veta në emër të Hyjnisë i lejoi vetes të bëjë ndryshime në këtë lutje. Ashtu si dallohet sot besimi ndër njerëz ashtu ndryshon edhe forma e agjërimit. Në esencë të gjitha fetë qiellore e kanë agjërimin në agjendën e tyre vjetore. Kjo, le të kuptojmë se zanafilla e agjërimit nuk është pjellë e ideve njerëzore por udhëzim i Krijuesit.

Historia islame na mëson se edhe neve (ithtarëve të Muhamedit s.a.v.s.) na është bërë obligim agjërimi, sikurse edhe popujve të më hershëm.

All-llahu e ka caktuar edhe kohën e agjërimit "Ditë të caktuara..." Bekare 184. Po në këtë urdhëresë, në ajetin 185 e thekson edhe muajin " Muaji i Ramazanit është (muaj ku filloi) të shpallet Kur'ani..." pra në këtë muaj të agjërimit.

Nga thëniet e Muhammedit s.a.v.s.

Transmeton Muslimi, se i Dërguari All-llahut ka thënë: Pesë faljet e namazit si dhe falja prej xhumasë deri në xhumanë tjetër dhe agjërimi Ramazanit deri në Ramazanin tjetër janë falje për mëkatet e mëdha (që eventualisht mund të bëhen ndërmjet këtij intervali).

Transmeton Muslimi, se i Dërguari All-llahut ka thënë: Nuk ju përjashtohet lutja tri personave: agjëruesit deri sa të bën iftar, kryetarit të drejtë dhe lutja e të pafajshmit..."

Mbështetjet tona në Kur'an dhe thëniet e Muhammedit s.a.v.s. na janë shumë të nevojshme sepse njeriu duke u bazuar në këto, do të kuptojë se ka të bëjë me një urdhër që nuk i përket qenies njerëzore. Këtë obligim njeriu së pari duhet ta marrë si lutje dhe adhurim ndaj Krijuesit, e pastaj mund të merret dhe të komentojë të mirat e tij.

Praktika e agjërimit

Zakonisht besimtari fillon ditën e tij me faljen e mëngjesit. Por në muajin e Ramazanit besimtari duhet të zgjohet pak më herët se zakonisht dhe para se të agojë dita, pra, në kohën e vegimit ai vendosë të agjërojë ditën e nesërme. Ky zgjim i hershëm nuk është obligativ por ishte praktikë e Muhammedit s.a.v.s. i cili është zgjuar para agimit, qoftë edhe për të pirë një gotë ujë.

Kur besimtari thotë se jam agjërueshëm ajo aludon në ndalimin e tij nga ngrënia pirja dhe marrëdhënia seksuale nga vegimi deri në perëndim të diellit. Nga agjërimi lirohen pleqtë të sëmurët, shtatëzanat, gjidhënëset, femrat gjatë menstruacioneve dhe lehonisë si dhe udhëtarët. Por nëse këta e ndiejnë veten të fuqishëm dhe vërejnë se agjërimi nuk i pengon fare nga përditshmëria e tyre atëherë këta mund të agjërojnë sepse agjërimi tyre do të ishte më i dobishëm.

Pse agjërojmë?

Para së gjithash besimtari agjëron për shkak të urdhrit të All-llahut. Ai ka besuar në Te, prandaj ai obligohet t'i bindet urdhrit të Tij. Çdo urdhër që vjen në emër të Zotit konsiderohet nga besimtari se është për të mirën e tij. Në këtë kontekst agjërimi konsiderohet një ndër lutjet kryesore të njerëzimit.

Agjërojmë për ta tejkaluar gradën e melekëve. " Vërtetë, Ne e krijuam njeriun në formën më të mirë (nga gjitha krijesat)..." el-Tinë, 4. Njeriu shpesh herë del nga kontrolli dhe humbet në jetë, prandaj edhe i Lartëmadhëruari ka theksuar se njeriu di të bëhet edhe krijesa më e ulët. Njeriu ka nevojë për rikujtime. Nëse do ta ndalojë veten me mos ngrënie dhe mos bërje seks gjatë një kohe të caktuar, ai shndërrohet në shembull para gjitha krijesave tjera në natyrë. Një veprim i tillë atë e bën të meditojë më thellë dhe më mirë, sepse në esencë ai ka të lejuara shumë veprime dhe ato ia ndalon vetvetes për një kohë, vetëm për hir të urdhrit të All-llahut të Lartëmadhëruar. Nëse këtë ndalesë e bën si shenjë adhurimi, ai kështu, do t'ia tejkalojë edhe melekëve. Në esencë melekët, nuk hanë e as nuk shumohen, duke qenë të tilla ato nuk e kanë idenë e kënaqësive të këtyre veprimeve. Kur njeriu me bindjen e vet, e ndalon veten nga këto të mira dhe kënaqësi për një periudhë kohore, ai ngrihet mbi melekët. Prandaj këtë sakrificë të madhe All-llahu e shpërblen pa masë.

Agjërimi e bën njeriun edhe më të pastër në shpirt, atij ia përforcon vullnetin e mirësisë dhe e largon nga veprat e liga dhe të shëmtuara. Në një rast Muhammedi s.a.v.s. tha: " Agjërimi është mbrojtje, ai që agjëron nuk ia lejon veten të bërtasë e as të flet fjalë të ndyta. Nëse dikush të ofendon, të shanë ose të bën të fjalosesh me dikë tjetër, thuaju: Unë jam agjërueshëm".

Të gjithë prindërit e "dëshpëruar" i kisha ftuar në vetëbesim, le të mos ngurrojnë dhe le të mos turpërohen me fëmijët e tyre besimtarë. Vallë, dëshpëroheni për fëmijën tuaj prej besimtari, kjo është çudi. A do të dëshironit që fëmija juaj të bos besojë... çudi. Por ama do të ishit pajtuar që fëmija juaj të jetë besimtar i mirë, e të mos bëhet një narkoman ose...

Solidarizimi i shoqërisë në këtë muaj është më i madh se në muajt tjerë. Prej lidhjeve më të forta njihet ndjenja e urisë. Me këtë veprim të pasurit hyjnë në brendinë e jetesës të skamnorëve, prandaj në fund të muajit jepet zekatul fitari, ndërsa ai që ka qasuri të bujshme duhet ta japë edhe zukatin. Ky solidaritet në esencë e ka ndjenjën e bashkimit mbarë njerëzor. Të paktën ditët festive do të janë të gëzueshme për të gjithë shkak i të cilit ishte solidariteti i agjëruesit. Zekati është analoge e ta-

timit vjetër, por ai nuk i drejtohet pushtetarëve, por skamnorëve. Kështu, ai që ka zekat, dhe nuk ia jep skamnorit ai kështu ia ka marrë hakun të varfëve. Secili mysliman e ka për obligim që zekatin ta shpërndajnë në rrethin ku ai jeton. Nëse rrethi tij nuk ka nevojë për zekat atëherë ajo shumë grumbullohet dhe iu jepet popujve që kanë nevojë emergjente. Ndihmat që vijnë nga bota arabe tek ne në Kosovë, konsiderohet si pasuri e jona e deponuar në botën islame sepse është haku ynë. Më këtë pasuri, pasaniku arab ose kudo që gjendet ai në botë, nuk mund të manipulojë, ajo i jepet në formë shumë rigoroze skamnorëve.

Çfarë agjëruesish kemi?

Agjëruesi nuk duhet ta ndërpresin punën e tij të përditshme, për shkak të ndjenjës së agjërimit. Nëse dikush ka mundësi të marrë pushimin vjetor në këtë muaj le ta marrë nëse mendon se do ta përcjellë këtë muaj me të gjitha të mirat e tij. Të falë më shumë namaz gjatë ditës, gjithsesi edhe namazet e natës dhe të mesnatës.

Fatkeqësisht kemi agjërues që agjërojnë për shkak të traditës së tij në familje e për shkak se e ndien se është urdhër i All-llahut. Kemi prej tyre që tërë ditën e kalojnë në gjumë, ose në forma të ndryshme të cilat nuk janë të traditë e përditshmërisë së tyre. Të tillëve ju ndodh që edhe namazet e rregullta t'ju kalojnë pa i falur. Por kemi edhe të atillë ashtu siç i cilëson Muhammedi s.a.v.s.: " Ka agjërues që prej tij nuk i ka ngelur asgjë përveç urisë, dhe gjithashtu ka adhurues që prej tij nuk i ka ngelur asgjë me përveç mosfjetjes".

Besimtari duhet ta shfrytëzojë muajin e agjërimit deri në maksimum sepse këto ditë nuk kthehen dhe përfitimet janë të paimagjinuara.

Agjërimi në trojet shqiptare

Sipas përqindjeve shumica e shqiptarëve janë besimtarë, prej tyre myslimanët janë shumicë, ndërsa të tjerët janë të krishterë dhe një numër i vogël ateistë ose agnostikë. Pas rënies së monizmit shqiptarët sikur kanë filluar të kthehen në origjinat e tyre. Ndërsa ateistët ende mendojnë se kanë epërsi ndaj besimtarëve. Në të shumtën e rasteve vazhdojnë të pengojnë besimtarët në forma të ndryshme, por në muajin e agjërimit pengesat janë më të dukshme. Ata mendojnë se duhet t'ua imponojnë bashkombasve të tyre idenë e mosbesimit ose mohimit të Krijuesit. Kjo vërehet nëpër shkolla ku disa prej arsimtarëve hapin debate neveritëse dhe të pa nevojshme me fëmijët (nxënësit) agjërues. Ata duhet t'i lënë të lirë nxënësit me bindjet e tyre, e jo të mundohen të ndikojnë së koti, sepse vetë ata tani janë dëshmitar të shtimit të të rinjve nëpër objektet e kultit.



Dikur moti, pas luftës së dytë botërore në Kosovë përqindja më e madhe e myslimanëve ka agjëruar, me kalimin e kohës mos agjëruesit u bënë shumicë. Mendoj për shkak të motiveve që ua ofronte komunizmi. Kujtojmë kohët, kur nëpër oda flitej për një njeri në një familje që nuk agjëronte, ishte çudi. Ky lajm përhapej me shpejtësi të madhe nëpër tërë Kosovën. Me kalimin e viteve mosagjëruesit u shtuan dhe roli ndryshoi, tani besimtarët informoheshin për familjet që agjëronin.

Ndërsa tani, pas luftës së fundit shumë "intelektualë" kanë ra në hall. Shpesh herë dëgjoj nëpër zyra ose restorante t'i ankohen njëri tjetrit. Hallet e tyre janë se fëmijët e tyre po agjërojnë ose po falen!? Ka ardhur koha e dëshpërimit për prindërit, por këta prindër të tanishëm kanë harruar se sa i paskan hidhëruar prindërit e tyre me lënien e agjërimit. Ka ardhur koha tani që fëmijët e tyre të hakmerren në hidhërim, por ndryshimi është se këta fëmijë të tanishëm thërrasin i prindërit e tyre në shpëtim pa marrë parasysh veprimet e tyre mëhershme, ndërsa fëmijët e atëhershëm (prindërit e tanishëm) prindërit e tyre i thirrin në komunizëm, mosbesim ose në shkatërrim.

Të gjithë prindërit e "dëshpëruar" i kisha ftuar në vetëbesim, le të mos ngurrojnë dhe le të mos turpërohen me fëmijët e tyre besimtarë. Vallë, dëshpëroheni për fëmijën tuaj prej besimtari, kjo është çudi. A do të dëshironit që fëmija juaj të bos besojë...çudi. Por ama do të ishit pajtuar që fëmija juaj të jetë besimtar i mirë, e të mos bëhet një narkoman ose...

Çka (nuk) e prishë agjërimin

Çdo gjë që bëhet pa qëllim nuk e prishë agjërimin, kurse e kundërta e saj e prishë. Harresa nuk llogaritet gabim, prandaj nëse harrojmë dhe ajo bën që të ha, të pi ose..., gjatë ditës duke qenë agjërueshëm nuk e prishim agjërimin. Por nëse kjo bëhet me qëllim atëherë juristët mysliman kanë shpjeguar masat e dënimit të parapara me Kur'an dhe hadithe të Muhammedit s.a.v.s..

Statusi i sëmurit u shpjegua, por nëse dikush mundet, dhe dëshiron të agjërojë ai duhet të dijë se cilat barëra e prishin, e cilat jo. Për t'ju përgjigjur kësaj, duhet një libër i tërë prandaj do të preferoja që të merren librat e fikut ose përgjigjet le të merren tek personat e ligjshëm në lokalitetet e tyre për probleme fetare.

Agjërimet e preferuara jashtë muajit Ramazan

Muhammedi s.a.v.s. e ka vlerësuar shumë këtë lloj lutje, nëse ju përmbahemi këtyre do të jemi të shpëtuar dhe më krenarë në ahiret.

Ai thotë: "Çdo gjë ka zekat, zekati i trupit është agjërimi kurse agjërimi është gjysma e durimit" Gjithashtu ka thënë "Agjërimi më i mirë pas Ramazanit është në muajin Muharrem, kurse namazi më i mirë pas atyre obligative është namazi i natës"

Ndërsa agjërimet e preferuara të Muhammedit s.a.v.s. ishin:

- **Ka agjëruar shumë nga fillimi i muajit Shaban.**
- **Tri ditë në dhjetë ditshin e parë të muajit Muharrem**
- **Ditën e Arafatit.**
- **Tri ditë për çdo muaj**
- **Çdo të hënë dhe të enjte**
- **Gjashtë ditë në muajin sheval (muaji menjëherë pas Ramazanit)**

Një histori e shkurtër për Mehmet Akif Ersoyn

Shqiptari që shkroi himnin e Turqisë

Mehmet Akif Ersoy (Pejani) njihet si ligjërues fetar, ligjërues fakulteti, këshillues politik, filozof, e njëherësh edhe poeti më i famshëm i letërsisë turke. Ai edhe sot kujtohet me epitetin me të madh, ngase ishte dhe mbeti poeti më i dashur për çdo qytetar të Turqisë, duke qenë edhe autor i himnit kombëtar turk

Agron ISLAMI

Nëse nisemi nga faktet historike, shohim se shqiptarët janë ndër popujt më të vjetër të Ballkanit, që gjatë gjithë historisë është përfshirë nga luftëra, në periudha e sisteme të ndryshme duke iu imponuar që të shpërngulen nga atdheu i tyre i shtrenjtë. Shumë atdhetarë shqiptarë njihen për kontributin e dhënë nëpër vendet, ku janë shpërngulur, duke mos harruar asnjëherë prejardhjen e tyre shqiptare.

Janë të shumtë ata që sot historia botërore i njeh për kontributet e tyre nëpër fusha të ndryshme, e njeri ndër këta padyshim ishte dhe mbetet MEHMET AKIF ERSOY, që është i njohur për kontributin e tij në fusha të ndryshme.

Mehmeti njihet si ligjërues fetar, ligjërues fakulteti, këshillues politik, filozof, e njëherësh edhe poeti më i famshëm i letërsisë turke deri në ditët e sotme. Ai edhe sot kujtohet me epitetin me të madh, ngase ishte dhe mbeti poeti më i dashur për çdo qytetar të Turqisë, duke qenë edhe autor i himnit kombëtar turk.

Ky personalitet i famshëm, që bëri emër në historinë e Turqisë, ishte njeri nga shumë shqiptarët, të parët e të cilit u detyruan të arratisen drejt Turqisë. Mehmeti në një poezi të titulluar "Vefasiz Kosova", me një ndjenjë dhimbjeje të thellë në shpirtin e tij shkruan për Kosovën:

Kudo që jam me përfytyrohet një
fushë me gjak
A jam në ëndërr apo je ti...Kosovë
A nuk mburreshe me pëllëmbët e
tokës sate...

(06 mars 1913)



Përkundër famës që bëri në Turqi, si duket poeti e ndjente veten shumë krenar me prejardhjen e tij, dhe në fund të kësaj poezie potencon edhe prejardhjen e tij:

Këtë dëgjoni nga unë, unë jam shqiptar
Nuk mund të them gjë tjetër...

Biografia

Mehmet Akif Ersoyi u lind në dhjetor të vitit 1873 në lagjen Sari-Güzel në rrethinën e Stambollit.

Babai i tij ishte Tahir Efendi Pejani (me prejardhje nga Shushica e Pejës). Që në moshë shumë të re me babain e tij, e morën rrugën e arratisë drejt Stambollit, atje vazhdoi shkollimin në medresenë e (Fatihut), dhe pas kryerjes se medresesë, personeli i shkollës shpreh dëshirën që Tahir Efendiu të ushtrojë detyrën e profesorit po në ketë medrese, ku punoi deri në vdekje. Ndërsa nëna e Akifit ishte Emine Sherif, me prejardhje nga Buharaja.

Akifi qysh si fëmijë pajiset me dituri fetare-islame nga prindërit dhe në moshën 4 vjeçare gjegjësisht me 1878, fillon mësimin për herë të parë në mektebin (parashkollore) "Emin Buhari".

Pas dy vite shkollimi, më 1879 kalon në shkollën fillore (Ruzhdiye), për të vazhduar në shkollimin e lartë fillore (Idadiye).


Krahas mësimeve që merrte në shkollë, prof. Tahiri djalit të tij i mbante mësim shtesë në shtëpi si; Tefsir (komentim kurani), Fikh (bazat e sheriatit), gjuhë arabe, ndërsa nga gjyshi i tij mësonte persishten e vjetër dhe nga e gjithë kjo shihet qartë se Akifi, qysh në moshë të re pati rastin të njihej me dituri të lëmive të ndryshme.

Pas 3 vite shkollimi fillor, me 1882 kalon në shkollimin e mesme në Fatih. Gjatë kësaj periudhe, Akifi

kishte një angazhim shumë të theksuar për moshën që kishte. Nga babai vazhdonte mësimin e gjuhës arabe, në xhaminë e Fatihut prezantonte në kursin e gjuhës persiane që organizohej nga gjyshi i tij, dhe gjatë kësaj kohe, në kurs u lexoheshin libra të njohur si; "Gülistan" "Mesnevi"... Njëkohësisht në shkollë ishte ndër nxënësit më të dalluar në të gjitha lëmitë, e në veçanti në gjuhën turke dhe franceze.
Qysh si nxënës i shkollës së mesme te ai vërehet një interesim për poezinë.
Në ketë kohë, fillon edhe përpjekjet e para për shkrimin e poezive me shokun e tij, Ibnulemin Mahmud Kemal.
Më 1885, atëherë kur e kreu shkollën e mesme, babai ia dha të drejtën që zgjedh profesionin e vetë, profesion ky, që do ta përcjell gjatë gjithë jetës. Akifi tani studimin e tij, do ta vazhdojë në shkenca politike. Gjatë kësaj periudhe shkollimi, që zgjati deri në vitin 1889, Akifi pati rastin që të dëgjoj ligjërata nga profesorët më të njohur në Turqi. Një ndikim të madh pati nga poeti i njohur turk Muallim Naci.

Veprimtaria poetike

Akifi pas vetes la shtatë vepra me poezi, që janë të përmbledhura në një libër të vetëm të quajtur "Safahat",



e cila përmbledhje është ndarë në shtatë vëllime sipas veprave në fjalë. Libri i parë mban titullin "Safahat". Në vazhdim ka shkruar librat: "Në ulësen e Sulejmanisë", "Zërat e se vërtetës", "Në ulësen e Fatihut", "Kujtimet", etj.
Veprat e Akifit, ishin të shkruara në shkrimin osman, por pas vdekjes së tij, i tërë safahati u transkriptua në shkronja latine nga ana e M.E.Düzdağ.
Të gjitha librat e tij, janë të botuara në Stamboll me përjashtim të librit të shtatë dhe të fundit, i cili u botua në Kajro të Egjiptit.

Fjala "SAFAHAT", në vete përmban një kuptim shumë të gjerë, që në gjuhën shqipe ka kuptimin; "fletët".
Nga vet emërtimi i veprës letrare së tij, shihet se në veprimtarinë e tij, poeti përshkruan (pothuajse) një epokë historike, jo vetëm të Turqisë, por të tërë botës islame.
Gjuha e përdorur në poezi, është gjuhë e Islamit që shtrihet në themelin e kulturës së poetit. Për rrjedhojë në peshoren e fjalorit të përdorur në këto poezi, hasen në një masë të madhe përveç turqishtes, veçanërisht njësi leksikore me burim arab. Bashkë me përdorimin edhe të fjalëve dhe ndërtimeve analitike persishte, poeti është përpjekur, që këto tri gjuhë t'i përdorë në mënyrë harmonike e të pëlqyeshme për veshin e lexues-dëgjuesit, që më shumë siguri mund të themi se është treguar i suksesshëm në përpjekjen e tij.
Pothuajse në shtatë librat e lartpërmendur, poeti nuk kalon pa i artikuluar dhimbjet e tij, që ka për luftërat që po zhvilloheshin në Ballkan nga forcat e mëdha, të cilat synonin ndarjen e shteteve, e në veçanti për tokën e të parëve nga ai vinte. Në një rast thotë:

Zgjohu baba, zgjohu nga varri, e shiko!
Si po ndahen 3 milion popull, për
shkakun e tri kokave të pa tru
...
Shqipëria po digjet, kësaj radhe me të madhe.



Leximi i tekstit

PËRSHËNDETJA E GJAKOSUR PERSONALE

Këtu, shtohen e bashkëshqiptohen variacionet e shkrimit të një përvoje jetësore, ndërmjet shtresimit brendor e gjendjes se shqiptuesit



Flamur MALOKU

Në poezinë "Në vend të përshëndetjes", Azem Shkreli e përkufizon në brendinë tekstore një ndarje personale, e cila ndarje bashkëthuret me një trishtim, me një ton agresiv. Të dy këto i përshkon vetëdija e trishtimit përballë ndarjes, e cila tani fuqishëm shpërthen në strukturën e tekstit. Pra, shprehja e ndarjes, e cila tani ka shkaktuar një dhembje personale, ku emocionaliteti së bashku me natyrën e brendshme të tij, do të krijon diskursin e mallkimit. Mallkimi personal, përballë asaj që ka kërkuar ndarje shprehet përmes ndjenjës së gjakosur.

Metafora si figurë bëhet karakterizim përgjatë shkrimit të ndarjes. Duke u nisur nga një përjetim konkret, ku tani ndarja rikthehet në një moment, i cili moment sprovon rrafshin emocional e personal. Rrafshi brendor, përballë gjakimit të ndarjes, e cila tani është bartur në figurë, e në të dhënën konkrete ka krijuar ftohtësinë shpirtërore, po edhe dhembjen dhe zbrazëtinë e thellë. Dhe nga kjo subjekti thurë diskursin e dëshpërimit, që shenjat e kësaj njohje dalin konkretisht përgjatë tekstit, duke argumentuar çdo herë perceptimin dhe arsyetimin e dhembjes së gjakosur personale. Edhe pse shkaktarët e ndarjes nuk theksohen në tekst, por kjo duhet të nënkuptohet, se kërkimi për ndarje në bazë të diskursit bëhet nga ajo, andaj subjekti i drejtohet me foljen shko, e cila përsëritet shumë herë në strukturën e poezisë:

Shko se furishëm po fryn në mua erë mallkimi që s'të falë. Dhe dije
Mirë, kurrë më e një e një nuk bëjnë një
Si thonte Hikmeti, aj farë poeti me këngë prej zjarri.

Folja shko, në fushë të realizimit e të botëkuptimit, nënkupton përjashtimin emocional, pas një përvoje të rëndë personale, e cila tani lidhet me një ndarje, plotësisht e përshkruar nga një shqetësim. Mirëpo, në strukturën e poezisë, përballë foljes shko, është edhe pjesëza mohuese 'mos', se një gjendje të cilën e ka përjashtuar nga brendësia emocionale, subjekti kërkon tani të mos rikthehet kurrë në vetëdijen e tij jetësore, sepse ka shkaktuar dhembje fizike dhe shpirtërore:

Sytë e përlotur në shtekballin tim. Mos thuaj lamtumirë.
Asgje mos thuaj. Merri me vete gjurmat nëpër të cilat
Erdhe një natë më e përvujtur se frika dhe hyre në mua Shko

Kthimi deri të gjakimi, të cilën e ka shkaktuar ajo nëpërmjet ndarjes, jep shenjat e pakënaqësisë së subjektit lirik, nëpërmjet ikjes së përflakur. Nga kjo përfitohet: tradhtia, braktisja dhe shenjat e joshjes, e cila dikur me saktësisht në natën e përvuajtur ka hyrë në zemrën e subjektit. Prandaj, shenjat e këtilla së bashku me shtresimet e dhembjes, të dhëna në tekst sintetizojnë vuajtjen dhe kultivojnë diskursin agresiv që vije si shkas i kërkimit të ndarjes nga ajo.

Rrafshi brendor bëhet një element karakterizues nëpër situatat e sprovuara. Sipas dëshmisë së autorit, çdoherë duke zbuluar brendësinë ndërmjet dashurisë së dikurshme dhe urrejtjes, e cila tani bëhet pikënisje motivore e vënë në ballë të poezisë. Largimi dhe kërkimi që bëhet nga subjekti nëpërmjet metaforave, kalon në shqiptim të pozicionimit, si njohje dhe kërkim, e cila është e shënjuar që në fillim. Edhe pse thellohet dhembja, subjekti kërkon largimin e asaj:

Mbyllu në do kështjella të largëta harrimi ku s'të zgjojnë më
Kumbonat e pendimit kur çmendet malli vetmia ose kur më buza buzën
E han n'pikllim që mëkatin s'e lan, që s'mund ta shpojë
Gurin e rëndë, gurin e ftohtë të ndarjes. Shko, më mirë
Dhe hesht. Mos u kthe mbas.

Këtu, shtohen e bashkëshqiptohen variacionet e shkrimit të përvojës jetësore, ndërmjet shtresimit brendor e gjendjes se shqiptuesit, është një dhembje e cila bëhet esencë e komentimit përgjatë përjetimit personal. E themi këtë, sepse shkrimi i plotë personal, duke sintetizuar çdoherë gjakimin e ndarjes e cila bëhet njohje e humbjes së dashurisë së dikurshme. Gjithashtu, kërkimi për largimin, më qëllim që të theksojë shqetësimin, hyn në të folurit dhe merr formën e vet të përhershme e të vazhdueshme, përgjatë strukturës së tekstit. Kjo realizohet përmes ligjërimit figurativ, duke dëshmuar çdoherë artikulimin e ndarjes dhe të

mungesës, mbi ndjenjën e moskthimit për tek ajo, sepse kthim më nuk ka. Tani çdo gjë është shkatërruar, duke shkaktuar kështu një dramatike të brendshme, andaj, as përshëndetjen e fundit autori nuk e do - lamtumirën e fundit dhe jo rastësisht subjekti thotë:

Dhe hesht. Mos u kthe mbas. Mos i harro
Sytë e përlotur n'shtekballin tim. Mos thuaj lamtumirë
E kur t'shkojsh larg, më larg se kjre blerimi n'blerim
E kur t'shkojsh larg, më larg se prej zemre në zemër
Aq larg sa ta harrosh edhe emrin tënd dhe zërin tim
Fshihu prej vetes
Shkurto flokëgjatat, mate me to mendjeshkurtrën tënde
Dhe mos qaj


Kjo, theksohet nga shtresimet e rënda personale, e të dhembjes, që shpërthejnë si klithje të përjetimit, e cila bëhet përhershmëri trishtuese përgjatë ndarjes, e cila kualifikohet në dhembje të madhe. Në esencë, kjo krijon edhe skemën e gjakimit;

NDRAJA - PËRJETIMI PERSONAL - GJAKIMI

Skema e këtillë në strukturën e poezisë funksionon që nga fillimi, po çdoherë përmes metaforës, e cila gjatë gjakimit të ndarjes luan rolin kyç. Gjithë kjo e artikulon lumturinë e dikurshme që tani ka kaluar në urrejtje të madhe personale, sepse ndarja ka trokit rëndë. Trokitja dhe largimi i vështirë shpirtëror dhe kalimi në urrejtje, identifikohet me moskthimin e subjektit për të cilën është i vetëdijshëm, prandaj, arsyetimi i largimit sa me shpejt bëhet ide kryesore e autorit, thjeshtë s'ndjen më obligim ndaj asaj. Mosbesimi dhe mëria subjektive dukshëm shënjohen në tekst. Subjekti duke qenë pjesëmarrës në këtë vuajtje dramatike, ku gëzimi i dikurshëm është kthyer në situatë të pangushëllueshme, me një vetmi, me një mungesë të madhe në shpirt, e cila ka shkaktuar një prekje fatale e pakrahasueshme me asgjë. Fataliteti dhe dhembja tani rrezatojnë dëshpërimin me refleksione tronditëse, ku tani kërkohet edhe harrimi i zërit, që dikur pëshpëritej dhe kërkohej me dashurinë me të madhe nga të dy të dashuruarit;

Aq larg sa ta harrosh edhe emrin tënd dhe zërin tim
fshihu prej vetes

Zëri dhe harrimi i tij bëhet shpalim i moskthimit, që lind si përplasje e brendshme shpirtërore, si përplasje me ndjenjën e urrejtjes, por me një guxim dhe sinqeritet të plotë, thellësisht të dalur nga brendia e subjektit. Fjala është për një besim, për një shpalosje të dashurisë që dikur ishte çdo gjë, e që tani ka shumëfishuar gjakimin në shpirtin e autorit. Tema e vuajtjes në shkrim merr një dimension kundërshtie me plot shenja të pakënaqësisë, ashpërsisë, refuzimit, të cilat e rrisin dramaticitetin subjektiv.


"Mbyllu në do kështjella të largëta harrimi ku s'të zgjojnë më"
(A. Shkreli)

Poezi

KOHA E ÇMON FJALËN

Rrahman FERIZI

MËKATET

Sa e largët koha
Pranë mëkateve
Sa e pakët koha
Pranë pendimit
Në amullinë e saj vrastare
Zebra me besim shënjestër
Goditën nga shtizat e helmuara
Nga surrogate mbi varkoj.
Gjurmët e plagëve lëngojnë
Dhe shtrihen në shtratin e dergjur
Sa shpejt udhëtojnë me shtizat e yjeve
Trupojnë ylberin e përdëllimit
Dhe trazojnë zjarrin në shpirt
Ndezin vatrën e tyre pa fikur
Nga adhuruesit e zjarrit
(djajtë) lëshojnë flakë pa tym
Mëkatet kodra mbi kokë të besimtarit
Miza para syve për injorantin
Pranverë e lulëkuqeve të pendimit
Në Verën e shijes së adhurimit
Vjeshtë e fletëve të këputura të jetës
Dimër i akullt i lotëve të shpresës

KOHË

S'kam kohë të lexoj atë që shkruaj
S'kam kohë të shkruaj atë që ndiej
Kur shkruaj
Në pavijonet e jetës ndalet koha
Shtrydhet mëkati i zemrës në lot të valë
Mbi çatinë e ëndrrave bien netët
Si fletë të lisit të vjetër
S'kam kohë!
Ky refren tingëllon në rimë
Mbi trenin e ambicieve të harbuara
O njeri
Ti ke kohë aq sa të posedon ty koha
Pajtohu me të dhe dallgët e saj
Merre pendën si lopatë
Dijen barkë
Në detin-jetë valë valë

SHKRUAJE NJË FJALË

Shkruaje një fjalë
Që e ndjen
E çmon
Mund të jetë një meteor në mynxyrë
Njeriu unikat kalon në rrugë të jetës
Brumin e kohës gatuaje në sfidë, në ngjyrë
E gdhenda fjalën, sita ndërgjegjeje
Rrugëtova sprovës së dijes
Të shkruaj qoftë një fjalë që koha ta çmojë
Thuaje një fjalë që e ndien
Shkruaje një fjalë që ti e çmon
Do të bëhet gur i kalasë se jetës
Shekujt do ta kujtojnë
Thuaje një fjalë që koha e çmon
Në arenën e dijës shkrije dritën e syrit
Njerëzve shëmbëlleju territ
Me majën e pendës shpoji misteret
Te pakuptimtës jepi kuptim
Thuaje një fjale që ti e çmon
Nga përvoja unikate dhe vuajtja e ndërgjegjejes
Shpirtit të flakëruar dhe ballit të regjur
Shkruaje një fjalë si ylber në horizont
Që del pas lotëve
Pulëbardhave të ëndrrave t'iu hapësh shpresë
Thuaje një fjalë që koha e çmon!

POROSI PËR BESIMTARIN

Jeto me shpresë qoftë edhe në fije kashte
Shpresën e humbin vetëm të humburit
Jeto një ditë të lumtur pas këtsaj nate
E kaluara ka ikur, e ardhmja e pamundur
Në oazën jetë gjeje ujin e pastër
Kënaqu me atë që e ke, ajo të jetë hallall
Ngritu vetëdijes së lartë sikur shkallës
Së paku të jesh i bukur në moral
Shtoj veprat e mira qoftë sa një qerpik
Do të bëhen anije në detin matanë
Afro me urtësi armikun në mik
Të jetosh i qetë pa zënkë pa vragë
Mos e tronditë shpirtin me hidhërim
As zemrën me valët e helmit të tij
Lidhu fort për litarin granit
Si luftëtari në fushëbetejë për flamurin
Sa ka prej të suksesshmëve në jetë
Që u rriten në flakën e sfidës
Ata krenar u ngritën përherë
Sa herë që sfidat ua zinin pritën
Por kurrë mos harro o njeri fisnik
Se mund të arrish diçka vet
E tëra është nga Ai plotë Mëshirë
Prandaj kujdes, kujdes, kujdes...!



PAQJA

Leximi i tekstit

PREJ JETËS NË LETËRSI

"Përmbledhja poetike NEUROSIS", e Musa Ramadanit

Zahrie KAPLLANAJ

Esenca e poezive përbëhet nga shenjat autobiografike. Shenjat autobiografike janë të sistemuara me përzgjedhje për të formuar një tërësi të caktuar ideore. Kjo tërësi nuk formohet si linjë mimetike e jetës (pa marrë parasysh përmasën jetësore). Teksti i largohet shumë dokumentaritetit.

Tregohet mospërfillje për kohë, vend, data e emra. Duke i shënjuar ato si gjysma e duke i fshehur, subjekti transmeton dëshirën për të mbuluar të dhënën, për të mos e mbyllur tekstin, por për ta hapur si funksion artistik.

Mospërfillja për dëshmitë, si mënyrë e shfaqjes, shndërrohet në lojë. Kjo lojë formon figurat. Në këtë kontekst, vendi që duket se del kufizuesi, moderatori i formës e idesë, e kryen këtë funksion duke u shndërruar në figurë, mbulohet me shtresën e fiksionit: "kulla e bardhësive".

Autori shprehet në vetën e parë më së shumti, jo gjithmonë. Ligjërimi zgjedh pozitën më të thellë si pikënisje. Pozita, lë përshtypjen se është ndërdija, ajo që shënjon mbresat.

Kohë ëndërrimi mbretëron

Ose vetëdija luan rolin e ndërdijes, sikurse vepron fiksioni me realitetin. Ligjërimi fiksional do ta largoj, qëllimshëm, vëmendjen e lexuesit nga vetëdija, realiteti. Ato janë në këtë rast shtresa e dytë, interteksti. Pozicioni shprehës,pra, është fiksional, por që ecën gjithmonë në tentim që të njëjtësohet me realitetin, duke e deshifruar me anën e krijimit ose duke e shifruar me petkun e letërsisë, një lojë kjo e vjetër sa jeta. Lojë kjo, sa e bukur, po aq e dhembshme. Gjithmonë në mes të dëshirës për të hyrë e arsyetimit për të dalë.

Kërkoja zgjimin
...
Po zgjimi ishte...
Akt i stërfundit
...
Gjer te zgjimi i fundmë
Ëndrra sa një çerek jete
Pushtetin e vet kishte shtrirë.

Nëse kërkojmë sasi biografike, autori e tregon vetë masën, sa një çerek jete, një kohë e kufizuar, por edhe jeta sa një pikë e pika sa një jetë. Poezitë poshtë shkronjave, që formojnë një tërësi prej A-Zh, kanë një harmoni ritmike, por pa rimë, masë, versifikacion, e një stil me kahje prozaizimi. Ato si funksion estetik e artistik nuk kanë vetëm funksion akustik/dëgjimor, po edhe funksion pamor. Këtë funksion e përplotësojnë: pikat, lëvizja e fjalëve brenda vargjeve, renditja etj. Shkrimi nuk shënjon të dhënën. Ai shënjon impresionin, ndonëse synohet më tej.



Një gjakim shqisor në takimin
e parë në bardhësi, që diku mes
vargjeve gjakon, gjakon të mos
jetë vetëm e vetëm impresion.

Është akt hyjnor ky takim. Kur kapet e pakapshmja, abstraktja e bëhet në njëfarë mënyre reale, shenjë, letërsi. Poezitë e Musa Ramadanit kanë përbërës edhe personazhet. Ata plotësisht i korrespondojnë formës, funksionit të paraqitjes, kompletimit poetik: pesimisti, i paralizuari, i sëmuri i minierave, formalistja e re që vdes, i alkoolizuari etj. Funksioni i tyre, si emra, edhe si role, zgjat deri në këtë përcaktim. Ata hynë brenda si modele të gatshme, funksionojnë dhe nuk zgjerohen më tej. Poezitë, me raste, paraqesin njësi mikrobiografike të shkrimit e frymëzimit. Subjekti aty e gjen veten të gjallë.

Jeta ime po frymon, jeta ime
...
E kryesisht pranë tekstit e vargjeve të lira

Vetëdija e të shkruarit shkrihet me dhembjen e frymëzimit. Edhe shkrimi është fiksional, e jo racional:

Kurrë s'kam marrë laps në dorë
Pa parandier çfarë mund të shkruaj
...
Po gjer te unë frymëzimi rrugë maratonike ka

Në fund të ciklit, prej pozicionit të ndjekur të së tashmes-unë jam, subjekti distancohet dhe e lë atë prapa si të kaluar-isha. Krejt në fund:

Ka dikë e vret bardhësia
E dikë (si duket) e shëron

Brenda është një fund rrëfimi, me një "si duket" që tërheq nga vetvetja subjekti. Shumë brenda poezitë ruajnë një rend narracioni-fabule, po shumë në gjenezë. E kam këtë ide kur po e lexoj fundin. Musa Ramadani jetën (vuajtjet, përshtypjet, sëmundjen, spitalin, vetminë) i shndërron në figurë, letërsi, art. Jeta, e para, i mbetet atij, kjo e dyta, figura e letërsia u takon të tjerëve, si mjet që kërkon bashkim. Bashkimin e krijon ajo që ka mundësi të ndahet (në shumë pjesë), jo ajo që mund të konsumohet po nuk ndahet, se s'ka vend për pranim. Musa Ramadani në librin "Neurosis", aq sa përçon jetë, po aq krijon edhe model letërsie, model universal.

Ruajtja e strukturës familjare

Qëllimi i raporteve të mira familjare nuk është vetëm siguria materiale, por edhe siguria shpirtërore

Mirsad KUTELI

Funksionet e familjes shqiptare po ndryshojnë dhe po përshtaten gjatë rrjedhave të ndryshme kohore. Megjithatë, në shoqërinë shqiptare familja akoma ka mbetur shumë e rëndësishme. Edhe pse industrializimi dhe kapitalizmi ka kapluar edhe vendin tonë, familja e ka ruajtur kompaktësinë e saj dhe nuk është shpërbërë. Ky është një indikacion shumë i rëndësishëm për shoqërinë moderne. Me faktin se ruajtja e strukturës familjare dhe përkujdesja ndaj saj shërben edhe në pengimin apo parandalimin nga dukuritë negative shumë të përhapura si: vjedhja, vrasjet, prostitucioni, krimi i organizuar, etj. Ngaqë, anëtarët e familjes përkujdesën për mbarëvajtjen dhe ekzistencën e ndërsjellë përbrenda familjes, qoftë ajo familje e vogël apo e madhe.

Në vendin tonë, në kohët e mëhershme, zakonisht i zoti i shtëpisë është përkujdesur për ekzistencën e tërë familjes së tij, kështu në njëfarë mënyre, apo në një tjetër, anëtarët e familjes kanë qenë të varur tek kryefamiljari, si konsekuencë kanë shprehur dashuri dhe interesa të veçanta për të. Ndërkaq, kohëve të fundit kur një realitet i tillë ka ndryshuar dhe tani disa anëtarë të familjes punojnë apo të themi më mirë, secili përkujdeset për ekzistencën e tij, këtu bëhet fjalë për një rend të ri shoqëror. Mirëpo, në esencë, raportet ndërfamiljare dhe respekti apo relacionet emocionale me familjen ende mbahen mirë dhe nuk duket ndonjë shkëputje. Mbase, kjo për arsyen edhe të kushteve të përgjithshme ekonomike, por edhe institucionale. Në vendet perëndimore, të rinjtë që dëshirojnë të ndahen nga familjet e tyre, shteti u siguron banim dhe punë apo ndihma sociale, gjë që shërben edhe



si shtysë e të rinjve për ndarje apo shpërbërje familjare. Shikuar nga një prizëm tjetër, kjo mund të duket si një avantazh, që atyre u sjell profite. Por, vështruar nga gjatësia kohore, menjëherë dalin në pah disavantazhet e shumta që kanë një impakt mbi shpërbërjen e ndërtimit të sistemit familjar. Për fat të mirë, tek ne nuk ekziston një ligj apo rregullore e tillë dhe nuk ekzistojnë kushte të tilla të ndarjes së fëmijëve nga prindërit. Si konsekuencë, edhe struktura e familjes shqiptare do të shpërbëhej. Jo vetëm të rinjtë do të bënin hapa të tillë duke ia kthyer shpinën prindërve dhe familjes, por edhe numri i divorceve do të rritej. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se jemi një shoqëri mjaft kompakte gjëra të tilla ndodhin shumë rrallë, mbase edhe për hir të namit të individit apo të familjes që është ruajtur si element nga e kaluara, apo thënë më mirë nga tradita shqiptare.

Kur përmendëm kapitalizmin dhe punën, duhet theksuar se qëllimi i raporteve të mira familjare nuk është vetëm siguria materiale (financiare), por edhe siguria shpirtërore.


Andaj, si konsekuencë e konditave dhe rrethanave të lartpërmendura kemi edhe gjendjen që akoma po mbizotëron në familjet tona. Dihet mirëfilli se familjet tona akoma kanë një përkujdes për anëtarët e moshuar të familjes, për dallim nga vendet tjera, në të cilat ekzistojnë institute apo shtëpi të ndryshme për akomodimin e tyre. Ndërkaq te ne, një kujdes dhe respekt i veçantë ende ekziston përbrenda familjes. Megjithëse, viteve të fundit vërehet një rënie e nivelit që ka ekzistuar më parë, struktura familjare nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të vrullshëm.

Botime të reja

Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE



Në edicion të Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë", gjatë këtij muaji dolën nga shtypi dy libra të rinj: Libri "ISLAMI I KEQKUPTUAR DHE FATKEQËSIA BOTËRORE" i autorit Dr. Milazim Krasniqi dhe libri "SUKSESI I GARANTUAR – EDUKIMI I DREJTË" i autorit Nexhat Ibrahimi



KURIOZITETE

Diamanti më i madh në botë është gjetur në Afrikën e Jugut

Në një minierë, në Afrikën e Jugut është gjetur diamanti më i madh në botë, njofton radioja kombëtare. Guri i çmuar i gjetur në provincën veriperëndimore, ka dyfishin e peshës së diamantit cullinan, i cili u gjet më 26 janar 1905. Ky kishte një peshë prej 3.106 karatesh. Ai u nda me vonë në disa pjesë, të cilat ndodhen sot si gurë te çmuar në kurorën britanike. Një sipërmarrje minierash bëri të njohur se guri i gjetur tani, është dërguar në Johanes-burg nën masa të rrepta sigurie.



Çdo të thotë të jesh fëmijë i Bill Gates-it!?

Derisa të gjithë ne nxisim fëmijët të përdorin kompjuterin pa kurrfarë limiti me qëllim që fëmijët tanë "të bëhen gjeni?!" këtë praktikë nuk e aplikon Bill Gates. Të jesh fëmijë i Bill Gates-it do të thotë të kesh kufizimet që nuk i kanë shumica e fëmijëve tjerë në përdorimin e kompjuterit.
Bill Gates u ka kufizuar fëmijëve të tij përdorimin e kompjuterit. Ai u ka dhënë leje që gjatë javës të përdorin 45 minuta në ditë ndërsa në fundjavë 1 orë. Këtë e ka shprehur Bill Gates në një konferencë drejtuar biznesmenëve në Otava.
"Vajza ime 10 vjeçare Jennifer, pasi i pëlqente shumë loja Viva Pinata, nuk largohej nga kompjuteri për tre orë rresht. Për këtë arsye bashkë me gruan time Melinda-n, vendosëm kufizime në përdorimin e kompjuterit në shtëpi. Jennifer, mund të përdorë sa të dojë kompjuterin për të kryer detyrat e shkollës por jashtë kësaj mund të përdorë 45 minuta në ditë gjatë javës dhe 1 orë në fundjavë", është shprehur pronari i Microsoft dhe personi më i pasur në botë, Bill Gates.
Gates të njëjtat kufizime i ka vendosur



edhe djalit të tij 7 vjeçar Rory, i cili ka pyetur Bill-in nëse gjatë tërë jetës do ta përdorte kompjuterin me kufizime, pyetje së cilës Gates i është përgjigjur duke thënë se kufizimet do të mbarojnë atëherë kur ai të rritet dhe të jetë i pavarur nga babi i tij. "Atëherë kufizimet do t'i vendosësh vet", është shprehur Bill Gates.
(albeu.com)

15 adresat e internetit që kanë ndryshuar botën

Interneti po ndryshon jo vetëm jetën por edhe botën. Keni menduar se kush janë 15 faqet e internetit që kanë ndryshuar botën në 10 vitet e fundit? Ja përgjigjja...

Ja lista:
1) www.eBay.com: U hap në vitin 1995 dhe aktualisht ka 168 milion përdorues. Ankand, ku shitet gjithçka, nga armët e deri te kafshët.
2) www.wikipedia.com: E hapur në vitin 2001, vizitohet nga 912 mijë vizitorë. Ky sajt ofron të dhëna enciklopedike falas. Çdokush është i lirë që të dërgojë shkrim për të ndryshuar tekstin.
3) www.napster.com: E themeluar në 1999, ky sajt ka mbledhur rreth vetes 500 mijë anëtarë. Ofron muzikë ilegale (pa autorizim të producentit), dhe kritikohet shumë nga këngëtarët dhe menaxherët e tyre. U mbyll në 2001-shin dhe më vonë pas ndryshimeve të bëra në sistemin e anëtarësimit u rihap.
4) www.youtube.com: Sajt për publikimin dhe shpërndarjen e videove. U themelua në vitin 2005. Çdo ditë vizitohet nga përafërsisht 100 milion njerëz.
5) www.blogger.com: U themelua në vitin 1999 dhe ka gjithsej 18.5 milion vizitorë. Njerëzit shkruajnë ditarët dhe artikujt e tyre personale.
6) **www.friendsunited.com:** U themelua në vitin 1999. Ka 15 milion përdorues dhe synon t i mbledh ish-shokët dhe shoqet e klasës.
7) www.drudgereport.com: Kjo faqe lajmesh u themelua në 1994 dhe çdo ditë ka nga 8-10 milion klikime. Ne vitin 1998, kjo faqe publikoi për herë të parë lajmin e skandalit të Monica Lewinsky-t.
8) www.myspace.com: E themeluar në vitin 2003, kjo faqe ka mbi 100 milion përdorues. Duke hapur faqen tuaj, ju arrini të takoheni dhe të njiheni me njerëz tjerë.
9) www.amazon.com: E themeluar në vitin 1994, amazon ka mbi 35 milion klientë nga 250 vende të ndryshme të botës. Bën shitjen e librave, CD-ve dhe DVD-ve.
10) www.slashdot.org: E themeluar nga Rob Malda në vitin 1997, slashdot vizitohet nga 5.5 milion vizitorë në muaj. Sajti ofron informacione rreth teknologjisë. Përveç saj, posedon edhe një forum të gjerë.
11) www.salon.com: E hapur në vitin 1995 çdo ditë vizitohet nga 3.5 milion persona. Në faqe gjenden artikuj të temave të ndryshme.
12) www.craigslist.org: U hap në vitin 1995. Çdo muaj paraqiten 4 miliardë faqe. Ofron shpallje dhe lajmërime gratis për ata që jetojnë në qytetet e mëdha.
13) www.google.com: U themelua në vitin 1998 nga Larry Page dhe Sergey Brin. Filloi si një tezë diplome dhe sot çdo ditë vizitohet nga rreth 1 miliardë njerëz. Aktualisht është faqja më e popullarizuar në botë.
14) www.yahoo.com: E themeluar në vitin 1994, Yahoo ka rreth 400 milion anëtarë. Sajti ofron e-mail, kërkim në internet dhe shërbime të medias.
15) www.easyjet.com: E themeluar në vitin 1995, vitin e kaluar arriti t'u ofrojë shërbim 30 milion pasagjerëve. Kjo faqe, bën shitjen e biletave me çmime të lira.

Përgatiti: Osman D. GASHI

MJALTI - ILAÇ I ËMBËL

Iliriana ALLOQI & Artan BEJTA

Mjalti është "lëng i ëmbël" natyror dhe ëmbëlsi e koncentruar e luleve, që përpunohet nga bletët dhe kthehet në shurup të pasur. Burimi i nektarit, nga i cili është bërë mjalti e përcakton ngjyrën dhe aromën e tij, ndërsa lloji më i mirë është mjalti me ngjyrë të çelur.


Mjaltin më të mirë e bëjnë bletët Roja, kurse e mbledhin nëpër vise malore dhe drunjtë e tyre. Pastaj kullohet dhe përpos një sasie poleni dhe enzimash, shumica e papastërtive eliminohen.

Për të bërë një kilogram mjaltë, bletës i duhet të përshkoj 360-460 mijë km largësi. Kjo largësi është për 11 herë me e gjatë se gjatësia e ekuatorit të rruzullit tokësor. Është llogaritur se për ½ kilogram mjaltë, bletës i duhet të bëjë 37.000 shëtitje nëpër lule. Mrekulli të veçantë paraqesin prizmat gjashtëkëndëshe të hojeve "një matematikë e lartë".

Struktura gjashtëkëndëshe, është forma më e përshtatshme gjeometrike për shfrytëzimin maksimal të masës sipërfaqësore. Sipas hulumtimeve shkencore-biokimike, të bëra në 39 lloje të mjaltit, është vërtetuar se mjalti përmban glukozë, fruktozë, minerale të shumta, si kalium, kalcium, litium, magnezium, kobalt, mangan, bakër, hekur, natrium, argjend, nikel, silicium, fosfor, klor, zink, ari etj. vitaminat B1, B2, B3, B6, C, të cilët ndryshohen nga kualiteti i nektarit dhe polenit. Në mjaltë janë zbuluar edhe materie azotike, enzime (invertaza, dijetaza, oksidaza, peroksidaza) dhe disa hormone. Mjalti për shkak të sasisë së lartë të mineraleve, rrit sasinë e estrogjenit tek femrat.

Mjalti si ilaç përdoret te këto sëmundje:

- sëmundjet e lëkurës
- sëmundjet e organeve të tretjes
- sëmundjet e mëlçisë
- sëmundjet e veshkave
- sëmundjet e zemrës
- sëmundjet e sistemit nervor
- sëmundjet e syrit
- sëmundjet gjenitale femërore
- sëmundjet e organeve të frymëmarrjes dhe sëmundjet alergjike.



Studime për veçoritë shëruese të mjaltit

Në një metastudim, dijetarë nga Zelanda e Re, kanë mbledhur dëshmi nga 22 studime mbi veprimin shërues të mjaltit. Përmes kësaj ata mundën të vërtetojnë se mjalti vepron kundër baktereve, zbut infeksionet ekzistuese dhe mbron plagën nga infeksione të tjera. Përveç kësaj mjalti nxit shtimin e indeve. Kështu, plagët shërohen përpjesëshmërisht dhe lënë më pak shenja.

Me gjithë vetitë e shumta pozitive, mjalti nuk është pranuar pothuajse aspak deri tani si ilaç për trajtimin e plagëve. Por, kjo mund të ndryshoj, shpresojnë studiuesit, pasi që mjalti në formë sterile mund të pranohet si ilaç.

Mjalti është njëkohësisht një antiseptik i mirë. Në një mjaltë "të pjekur" mirë, bakteret nuk mund të rrinë më tepër se 2 orë. Në një varrezë të vjetër të mbretit të Egjiptit është gjetur mjaltë 3300 vjeçar, i cili me gjithë kalimin e shumë viteve ishte forcuar, i kishte ndryshuar ngjyra, por nuk i kishte humbur natyraliteti.

Për të sëmurët e diabetit, megjithëse sheqeri është një ushqim vdekjeprurës, të mjalti nuk ekziston një rrezik i tillë. Ai pastron gjakun, rregullon qarkullimin e tij, ndihmon në shërimin e sëmundjeve kockore, largon forcimin e damarëve të gjakut, shërben si qetësues në sëmundjet nervore dhe shumë aftësi të tjera kuruese. Megjithëse produktet e ëmbla shpesh nuk janë të rekomandueshme për shëndetin, mjalti mbetet ende ushqim i veçantë për shkak të vitaminës B, që përmban.

Kujdes duhet te kenë në përdorimin e mjaltit, për foshnjat "mjalti nuk duhet

t'u jepet fëmijëve nën moshën një vjeçare"... Jo vetëm fëmijët e vegjël, por, as të rriturit, nuk mund të përballojnë tretjen në mënyrë optimale të tij. Mjalti, ka përmbajtje shumë të madhe sheqeri. 300 gram sheqer, mund të krahasohen me 250 gram mjaltë.
Vetëm pas zbulimit të antibiotikut, në vitet 40 u "zhduk" mjalti përsëri në kuzhinë. Mjalti është shumë i dobishëm. Ai është mjet për shpëlarje dhe laksativ. Përmban veti pastruese dhe forcuese, i pastron arteriet dhe zorrët nga papastërtitë. Eliminon bllokimin e melqisë, të veshkave edhe të fshikëzës urinave, është gjithashtu konzervans i përgjithshëm.
Mjalti gjithashtu ndihmon në parandalimin e hyrjes së lagështisë në zorrë, siç ndodh në të sëmuret me diarre "barkqitje".
Prandaj, nëse hahet tejet mase mund të jetë i dëmshëm, sepse nëse nuk tretet me uthull shkakton vrer. Është i mirë për njerëz të moshuar, e ndal kollitjen dhe në mjekësi është përdorur për shërimin e sekrecioneve jo të pastra "të ndotura" në lukth dhe për ta nxehur tërë strukturën e trupit, për shkak të vlerës klorike të madhe.
Mjalti gjithashtu është ilaç i mirë që kthen oreksin e humbur dhe kur pihet i tretur në ujë të nxehtë dhe në shurup trëndafili, ndihmon shërimin e të sëmurëve nga rabiesi "tërbimi" dhe është konstatuar se vepron si sistem mbrojtës kundër infeksioneve të mëtejshme. Gjithashtu është përdorur si kundërhelm për ata që përdorin drogë, dhe në mes tjerash si antitoksinë në shërimin e helmimit të rastësishëm nga ngrënia e bimës së famshme, hija e natës "HYOSCYAMUS NIGER" ose këpurdhave të egra "helmuese".
Kur pihet i tretur në ujë të nxehtë, është ilaç i mirë kundër plagëve të shkaktuara nga kafshimi i qenit. Kalimi i lehtë i dorës së lyer me mjaltë nëpër flokë, si yndyrë, do të zhdukë morrat dhe parazit të tjerë. Gjithashtu përdoret si zbutës dhe freskues i flokëve, përshpejton rritjen e tyre.
Vetitë natyrore e bëjnë mjaltin plotësues dhe tretës të shkëlqyer, i hap poret e enëve të gjakut dhe lehtëson rrjedhjen e gjakut menstrual, liron sekrecionet, ndihmon metabolizmin etj. Asnjë lloj sheqeri nuk përmban dritën e diellit të përpara shumë muajve, asnjë ëmbëlsirë nuk përmbledh në vetvete erën origjinale të mollës, portokallit, blirit apo jonxhës, përveç mjaltit.







Psikologji

Fobitë më të zakonshme

Jeni i tmerruar nga gjarpërinjtë? I frikësuar nga merimangat? Atëherë, nuk jeni te vetmit. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetit Mendor (SHBA) dobitë i prekin rreth 10% të të rriturve. Ekziston një numër sqarimesh çka i zhvillon dobitë, përfshirë këtu teoritë e sjelljes dhe ato evolucionare. Çfarë do që të jetë shkaku dobitë janë gjendje që mund të trajtohen dhe të tejkalohen me teknika dhe terapi të ndryshme



Bujar SEJDIU

Prej çka frikësohen njerëzit më së shumti? Fobitë e poshtëshënuara, duke filluar nga TOP 10, janë ato me të shpeshtat dhe me të zakonshmet frika nga të cilat shkakton simptome si marramendje, mbetja pa frymë, etj. Në disa raste këto simptome eskalojnë deri në një sulm të plotë të panikës. Këto fobi në mënyrë tipike përfshijnë ambientin apo rrethinën, kafshët apo situata specifike.

Edhe pse numri i fobive arrin qindra, me poshtë janë përmendura disa prej tyre qe janë me të shpeshta duke filluar nga dhjetë me të zakonshmet:

Arachnophobia:
Frika nga merimangat – kjo fobi duket t'i infektojë me shumë femrat se meshkujt

Ophidiophobia:
Frika nga gjarpërinjtë – me shumë u atribuohet rasteve evolucionare, përvojave personale apo ndikimeve kulturore

Acrophobia:
Frika nga situatat dalja nga të cilat është e vështirë – kjo mund të përfshijë zonat e ngarkuara, vendet e hapura, apo situatat që mund të nxisin ndonjë sulm paniku. Ne këto raste njerëzit fillojnë t'iu shmangen këtyre rasteve, e nganjëherë deri në pikën ku izolohen në shtëpitë e tyre. Përafërsisht një e treta e njerëzve me çrregullim panikor vuajnë nga agoraphobia


Acrophobia:
Frika nga lartësitë – kjo frikë apo fobi mund te arrin deri të sulmet e ankthit dhe shmangies së vendeve të larta si p.sh. ndërtesat e larta

Cynophobia:
Frika nga qentë – kjo fobi me shumë shoqërohet me përvoja të caktuara personale si p.sh kafshimi nga qentë gjate fëmijërisë apo rate të ngjashme.

Astraphobia:
Frika nga bubullima dhe vetëtima – poashtu e njohur edhe si Brontofobia, Tonitrophobia apo Ceraunophobia

Trypanophobia:
Frika nga injeksionet – si shumë fobi të tjera edhe kjo fobi hynë në rendin e atyre fobive që nuk është lehtë të trajtohet pasi që njerëzit i largohen situatave apo objekteve që shkaktojnë frikë.

Social Phobias apo Fobitë Sociale:
Frika nga situatat sociale – në shumë raste këto fobi mund të jenë aq të shpeshta sa që njerëzit me ketë frikë iu shmangen ngjarjeve, vendeve dhe njerëzve që mund të shkaktojnë sulm të ankthit.



Pteromerhanophobia:
Frika nga fluturimi - shpesh trajtohet duke përdorur terapinë e ekspozimit, në të cilën pacienti gradualisht dhe në mënyrë progresive njoftohet apo paraqitet para fluturimit.

Mysophobia:
Frika nga mikrobet apo papastërtia – kjo fobi apo frikë mund të lidhet me çrregullim obsesivo-kompulsiv

Edhe pse lista me numrin e fobive është me qindra, me poshtë janë paraqitur vetëm disa prej tyre:

Acrophobia, Altophobia - frika nga lartësitë.
Agoraphobia - frika nga një vend apo ngjarje ku ikja është e pamundur apo kur ndihma është e pamundur
Algophobia — frika nga dhimbja.
Androphobia - frika nga meshkujt
Aquaphobia, Hydrophobia - frika nga uji
Arachnaphobia - frika nga merimangat
Astraphobia, Astrapophobia, Brontophobia, Keraunophobia - frika nga bubullima, vetëtima apo stuhitë
Autophobia - frika nga të qëndruarit vetëm
Aviophobia, Aviatophobia - frika nga fluturimi.
Bacillophobia, Bacteriophobia, Microbiophobia - frika nga bacilet, bakteret dhe mikrobet
Claustrophobia - frika nga vendet e mbyllura
Dentalphobia, Dentophobia, Odontophobia - frika nga dentisti dhe nga procedurat detale.
Dysmorphophobia, or body dysmorphic disorder - obsesion fobik për defekt real apo të imagjinuar të trupit
Glossophobia - frika nga të folurit në publik
Gymnophobia - frika nga nuditeti
Heliophobia - frika nga drita e diellit
Hemophobia, Haemophobia - frika nga gjaku
Hexakosioihexekontahexaphobia - frika nga numri 666
Necrophobia - frika nga vdekja, i vdekuri
Nyctophobia, Achluophobia, Lygophobia, Scotophobia - frika nga errësira.
Pyrophobia - frika nga zjarri.
Taphophobia - frika nga varri, apo frika nga futja në varr përse gjalli.
Tokophobia - frika nga lindja e fëmijut
Trypanophobia, Aichmophobia, Belonephobia, Enetophobia - frika nga gjilpërat, injeksionet apo objektet më maje.
Xenophobia - frika nga të huajt, të panjohurit apo jashtëtokësoret.
Zoophobias - term i përgjithshëm për fobitë nga shtazët
Ailurophobia - frika nga macet
Apiphobia, Melissophobia - frika nga bletët
Chiroptophobia - frika nga lakuriqet e natës
Cynophobia - frika nga qetë
Entomophobia - frika nga insektet.
Equinophobia, Hippophobia - frika nga kuajt
Herpetophobia - frika nga reptilët
Musophobia - frika nga miu.
Ophidiophobia - frika nga gjarpërinjtë.
Ornithophobia - frika nga zogjtë

Këshilla për karierën tuaj

Strategjia se si ta fitosh një punë

Shkelzen NUZA

Ju keni dërguar nëpërmjet emailit, apo postës dokumentet tuaja për një numër të caktuar të pozitave për punë dhe ju prisni se do t'u kontaktojnë për intervistë. Ju çdo ditë shfletoni gazetat në mos ka dalë ndonjë konkurs i cili do t'u përshtatej juve apo në të cilin ju do të mund ta gjenit veten...
A duhet edhe diçka tjetër ju të bëni kur kërkoni punë? Absolutisht!
Këtu më poshtë po ju japim disa nga strategjitë që duhet t`i përdorni që të shfrytëzoni mundësit për punë:

Kontaktoni organizata profesionale të lëmisë suaj

Ekzistojnë organizata profesionale kombëtare, regjionale dhe lokale, që mund



të ju ndihmojnë të jeni anëtar i tyre dhe të zhvilloni karrierën tuaj profesionale. Shumica prej këtyre organizatave kanë Ëeb Site-et e tyre dhe afishe nëpër rrugë ku lajmërojnë për mundësi punësimi.

Vizitoni Web Sajtet e kompanive dhe të organizatave

Shumë kompani dhe organizata i postojnë vendet e lira të tyre të punës në Web Sajtet e tyre.
Aplikoni direkt në organizatat që kanë fushëveprimin që ju përshtatet juve.
A e dini se ju dëshironi të punoni për kompaninë X ,apo për organizatën Y? Nëse është kështu, dërgoni një CV dhe letër motivuese të punuar mirë në atë kompani, qoftë në zyrën për burime njerëzore apo edhe me mirë të personi i cili është përgjegjës për fushëveprimin e interesit tuaj, i cili do të vendosë se kush do të merret në punë e kush jo. Zakonisht nuk është e lehtë të gjeni personin e duhur ta kontaktoni, por ju duhet të bëni përpjekje pr një gjë të tillë.

Lidhje, Lidhje, Lidhje

Në përgjithësi, mënyra më e shpejtë për tu punësuar është shfrytëzimi i lidhjeve. Lidhje është të kontaktosh me njerëz me njerëz që kanë kompetenca aty në mënyrë që ai të iu ndihmojë edhe të iu informoj për vendet e lira të shpallura me konkurs, apo edhe të pashpallura në konkurs. Fillimisht bisedoni me familjen tuaj, shokët tuaj dhe të afërmit tuaj për këtë çështje. Lëreni të kuptojnë gjithsecili se ti je duke kërkuar punë dhe gjithashtu jepu edhe idenë se për çfarë punë jeni të interesuar.

Bëhuni pjesë e asociacioneve profesionale

Nëse ekziston ndonjë organizatë profesionale e fushëveprimit tuaj, bëhu sa më shpejt pjesë e saj, dhe fillo të marrësh pjesë nëpër takimet e tyre në mënyrë që të njihesh me njerëzit kompetent të fushëveprimit tuaj. Puno më ndonjë këshilltar për karrierë në mënyrë që të kuptosh se cilat janë rrugët që ju duhet t`i ndiqni në mënyrë që të bëheni pjesë e një kompanie apo organizate e të zhvilloni karrierën tuaj aty. Dhe në fund mos harro t`i shfrytëzosh lidhjet tua me profesorët.

Merr pjesë nëpër panairet e punës


Shumica e qyteteve, në veçanti ato qytetet e mëdha, organizojnë panaire të ndryshme brenda vitit. Gjithashtu, edhe kolegjet dhe universitet mbajnë panaire të tilla, qoftë individualisht qoftë edhe në bashkëpunim me institucionet relevante. Panairi i punës është rast i rrallë për punë, kështu që mos lejoni që rastet të tilla të ju kalojnë.

Shfrytëzoni agjencitë e ndryshme për punë


Ekzistojnë kompani të ndryshme të cilat janë të specializuara që të ju ndihmojnë njerëzve që të gjejnë punë. Disa prej tyre janë të fokusuara te studentët e kolegjeve si dhe te ata të sapo diplomuar. Ndoshta ndonjëra prej tyre do të mund të ju ndihmoj juve.

Merrni parasysh edhe punët me gjysmë orari

Shpesh ndodh që, duke punuar me gjysmë orari në një kompani, ju mund të zini vend të përhershëm aty herët apo vonë. Edhe nëse kjo nuk ndodh, sidoqoftë, puna me gjysmë orari ju ndihmon juve që të takoheni me njerëz të kompanive të ndryshme ,të cilët ndoshta do të shprehin interes t'ju kenë pjesëtar të kompanisë për një pagë të majme.



Fjalëkryqi



HORIZONTALISHT

1. Solisti ynë, Krasniqi 2. Lloj vishnje spanjolle 3. Ushtari i ri në Perandorinë Osmane 4. Kali i Stërvitur – Floriri 5. Emri i vjetër i Japonisë(shq.) 6. Grami – Fabrika 7. Futbollisti shqiptar, Tare – Anton Pashku 8. Qytet në Venezuelë – Energjia 9. Gjysmë maturanti 10. Degë e administratës që ushtron veprimtari të caktuar (shq.) – Regjisori japonez, Kurosava 11.Legjendë – Miratim zyrtar 12. Eni Lenoks – Film i F. Felinit (shq.) 13. Jo fshehurazi – Jetëshkrimi 14. Gaus – Aktorja franceze, Vali – Shkronjë greke –Z 15. I.G.B – Banor i Tatarisë – Qytet dhe banjë në Belgjikë 16. Enë druri e rrumbullakët – Peshkop ortodoks 17. Shëndetësore – Aktori amerikan, Rejnolds 18. Qytezë, liman afër Splitit – Bashkimi harmonic i ngjyrave 19. Nikel – Solistja kanadeze, Moriset – Qelq.

VERTIKALISHT

1. Futbollisti nga foto (K.F. Uells) – Aktor i njohur 2. Emër mashkulli (shq.) – Që lufton në grupe të vogëla – Njësi peshe (shq.) 3. Vënie në përdorim (sh.shq.) – Shtet në Afrikë (shq.) 4. Kafshë e egër gjitare, mishngrënëse – Hyjni e egjiptasve të vjetër – Kripë (lat.) – Objekt fetar (shq.) 5. Qytet në Kosovë – Pamoralshmëri – Litri 6. Valltare baleti – Fushat – Deka , Amper – Liman në Izrael 7. Shega - Oreksi – Lëshohet flututrakeja ne aeroport 8. Urani – "Irish Republic Army" – Thirrje zyrtare (shq.) 9. Uzinë për përpunimin e naftës – Oliver Stoun 10. Minutat (turq.) – Sulfur e Brom 11. Aktor i njohur amerikan 12. Triadë – Pjesë e shtëpisë, dera 13. Lumë në Tajlandë (shq.) – Pushtim, nështrim me forcë